ADEM ZAPLLUZHA

KUR DËNESIN VARRET

ADEM ZAPLLUZHA

KUR DËNESIN VARRET

Redaktor:
Gjin Musa

Recensent:
Gjin Musa

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

Redaktor:
Gjin Musa

Recensent:
Gjin Musa

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

ADEM ZAPLLUZA

KUR DËNESIN VARRET

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

ADEM ZAPLLUZA

KUR DËNESIN VARRET

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

ADEM ZAPLLUZHA

4

Kur në poezinë e Zaplluzhës dënesin varret

Gjin Musa, Gazetar, analist dhe publicist. Romë, 29 nëntor 2018 Në legjendën madhështore të besës së dhënë kemi figurën emblematike të Kostandinit, i cili ngrihet nga varri për të mbajtur fjalën që i kishte dhënë nënës për t'ia sjellë motrën Doruntinë. Mbi kalë ecin i vdekuri me të gjallë, vëllai i rënë në luftë me të motrën e gjallë që kthehet tek nëna, e cila i ka varrosur të gjithë djemtë e saj, që ranë për vatan. Kurse në poezinë e Adem Zaplluzhës gjejmë të unifikuar në një, të vdekurin dhe të gjallin. Mendoni për një çast një njeri që lëviz trotuarit duk,e mbajtur brenda tij kufomën e vet. Duket makabre, por në të vërtetë poeti Zaplluzha me këtë metaforë të goditur ngre simbolin e atij njeriut inaktiv e të padobishëm për asgjë, që në fakt ka vdekur për së gjalli. Në qendër të poezisë së tij autori ve unin e vet poetik, një njeri që lëviz në një kohë pa kohë, që ndihet i vdekur edhe kur është në ambiente me të gjallët, kur edhe ata kanë vdekur shpirtërisht, duke u kthyer gati në qenie surreale. Librin e tij autori e titullon “Kur dënesin varret”. Metafora është e bukur dhe e madhe që në titull. Imagjinoni një varrezë të madhe, sa mezi i shihet fundi, ku nga varret vijnë

KUR DËNESIN VARRET

Kur në poezinë e Zaplluzhës dënesin varret

Gjin Musa, Gazetar, analist dhe publicist. Romë, 29 nëntor 2018 Në legjendën madhështore të besës së dhënë kemi figurën emblematike të Kostandinit, i cili ngrihet nga varri për të mbajtur fjalën që i kishte dhënë nënës për t'ia sjellë motrën Doruntinë. Mbi kalë ecin i vdekuri me të gjallë, vëllai i rënë në luftë me të motrën e gjallë që kthehet tek nëna, e cila i ka varrosur të gjithë djemtë e saj, që ranë për vatan. Kurse në poezinë e Adem Zaplluzhës gjejmë të unifikuar në një, të vdekurin dhe të gjallin. Mendoni për një çast një njeri që lëviz trotuarit duk,e mbajtur brenda tij kufomën e vet. Duket makabre, por në të vërtetë poeti Zaplluzha me këtë metaforë të goditur ngre simbolin e atij njeriut inaktiv e të padobishëm për asgjë, që në fakt ka vdekur për së gjalli. Në qendër të poezisë së tij autori ve unin e vet poetik, një njeri që lëviz në një kohë pa kohë, që ndihet i vdekur edhe kur është në ambiente me të gjallët, kur edhe ata kanë vdekur shpirtërisht, duke u kthyer gati në qenie surreale. Librin e tij autori e titullon “Kur dënesin varret”. Metafora është e bukur dhe e madhe që në titull. Imagjinoni një varrezë të madhe, sa mezi i shihet fundi, ku nga varret vijnë

5

vazhdimisht dënesa. Zakonisht dënesin të gjallët për ata që janë ndarë nga jeta, kurse në poezinë e Zaplluzhës janë vetë varret që dënesin. Qëndroja i stepur ose isha ulur kacule dhe i numëroja lopatat me dhe që binin mbi kurmin tim. Ende edhe sot më kujtohen çastet isha i vdekur ose dheu ishte një shi i imagjinuar. Kështu shkruan autori në poezinë që hap vëllimin. Kurse në poezinë që vjen më pas ai u drejtohet të tjerëve: Kurse ju të vdekurit e gjallë mendoni se kurmi juaj mund të preket me sytë e vëngër të erës. Jo, miqtë e mi të vdekur, para shumë viteve i përpitë lopatat me dhe. Autori i kushton një cikël të tërë në vëllim dënesës së varreve. Por nuk mund të thuhet se poezia e tij është e trishtë. Edhe pse ajo vjen pas luftës në Kosovë, ku familje të tëra u shuan plotësisht në altarin e lirisë, duke derdhur gjak për Kosovën martire, autori e vëzhgon me sy kritik realitetin, duke evokuar ringjalljen, por një ringjallje nëpërmjet njerëzish aktivë, që e duan vendlindjen, që e duan të ardhmen e fëmijëve dhe punojnë aktivisht për të. Për të është i papranueshëm ai realitet ku edhe “kufomat jetojnë duke mbledhur tasat e konservave ose ushqehen me konserva të skaduar”. Në poezinë “Të

ADEM ZAPLLUZHA

vazhdimisht dënesa. Zakonisht dënesin të gjallët për ata që janë ndarë nga jeta, kurse në poezinë e Zaplluzhës janë vetë varret që dënesin. Qëndroja i stepur ose isha ulur kacule dhe i numëroja lopatat me dhe që binin mbi kurmin tim. Ende edhe sot më kujtohen çastet isha i vdekur ose dheu ishte një shi i imagjinuar. Kështu shkruan autori në poezinë që hap vëllimin. Kurse në poezinë që vjen më pas ai u drejtohet të tjerëve: Kurse ju të vdekurit e gjallë mendoni se kurmi juaj mund të preket me sytë e vëngër të erës. Jo, miqtë e mi të vdekur, para shumë viteve i përpitë lopatat me dhe. Autori i kushton një cikël të tërë në vëllim dënesës së varreve. Por nuk mund të thuhet se poezia e tij është e trishtë. Edhe pse ajo vjen pas luftës në Kosovë, ku familje të tëra u shuan plotësisht në altarin e lirisë, duke derdhur gjak për Kosovën martire, autori e vëzhgon me sy kritik realitetin, duke evokuar ringjalljen, por një ringjallje nëpërmjet njerëzish aktivë, që e duan vendlindjen, që e duan të ardhmen e fëmijëve dhe punojnë aktivisht për të. Për të është i papranueshëm ai realitet ku edhe “kufomat jetojnë duke mbledhur tasat e konservave ose ushqehen me konserva të skaduar”. Në poezinë “Të

6

pushojnë si i ka hije një të vdekuri” ai shkruan: E njoh historinë e këtij vendi, sa e sa herë pushtetet e huaja na i lëruan varret e ne mbetëm si gjithmonë pa varr e nishan, mbetëm si qirinjtë e varur në hapësirë. E mbase kjo është një nga arsyet që varret dënesin. E para kësaj dënese nuk mund të rrihet indiferent, siç ndodh për fat të keq në shumë raste. Kjo i dhemb shumë poetit, ndaj ai si nga qivuri që ia kanë ndërtuar me rrapin e atdheut, e ngre me rebelim zërin: Kur dënesin varret, njerëzit heshtin, heshtin se nuk kanë guxim të paraqiten pranë altarit të turpit. Autori e ka konceptuar librin e tij në tre cikle. Në ciklet “Përpos një vegimi të largët” dhe “Me një kartolinë në sqep”, ai e zgjeron diapazonin e poezisë së tij, duke i lënë vend edhe poezisë lirike. Ai dëshmon se është njohës i mirë i vargut, i figurave të goditura letrare, veçanërisht i metaforës dhe vargjeve të tija metaforat larushitin duke i dhënë shkëlqim fjalës artistike. Nëse ti nuk vjen sonte, çfarë të bëj me vetminë time, më janë lodhur duart, si mund ta përqafoj fotografinë e varur në murin e kujtesës. Kurse tek poezia”Kur m'i vunë prangat e fjalëve”, autori dëshmon se kurrë nuk reshti për t'i dhënë liri mendimit e vargut të tij, por

KUR DËNESIN VARRET

pushojnë si i ka hije një të vdekuri” ai shkruan: E njoh historinë e këtij vendi, sa e sa herë pushtetet e huaja na i lëruan varret e ne mbetëm si gjithmonë pa varr e nishan, mbetëm si qirinjtë e varur në hapësirë. E mbase kjo është një nga arsyet që varret dënesin. E para kësaj dënese nuk mund të rrihet indiferent, siç ndodh për fat të keq në shumë raste. Kjo i dhemb shumë poetit, ndaj ai si nga qivuri që ia kanë ndërtuar me rrapin e atdheut, e ngre me rebelim zërin: Kur dënesin varret, njerëzit heshtin, heshtin se nuk kanë guxim të paraqiten pranë altarit të turpit. Autori e ka konceptuar librin e tij në tre cikle. Në ciklet “Përpos një vegimi të largët” dhe “Me një kartolinë në sqep”, ai e zgjeron diapazonin e poezisë së tij, duke i lënë vend edhe poezisë lirike. Ai dëshmon se është njohës i mirë i vargut, i figurave të goditura letrare, veçanërisht i metaforës dhe vargjeve të tija metaforat larushitin duke i dhënë shkëlqim fjalës artistike. Nëse ti nuk vjen sonte, çfarë të bëj me vetminë time, më janë lodhur duart, si mund ta përqafoj fotografinë e varur në murin e kujtesës. Kurse tek poezia”Kur m'i vunë prangat e fjalëve”, autori dëshmon se kurrë nuk reshti për t'i dhënë liri mendimit e vargut të tij, por

7

ngrihej kundër censurimit të fjalës. Kur m'i vunë prangat e fjalëve unë këndova, isha rapsodi i cili mund të këndonte me vite të tëra pa përsëritur kurrë dy herë një këngë. Dhe në një poezi tjetër ai e shpalos lirshëm e pa droje shpirtin e tij çapkën që e dashuron jetën dhe lirinë e vet. Isha poeti më i shthurur në botë, putha sa herë më donte shpirti, me ëndrrat e ëndërruara nuk mund të krahasohej asnjë perëndi. Ndërsa në poezinë e goditur lirike “Si t'i prek flokët e tu kur bëhen erë”, autori tregon delikatesën e tij dhe finesën e vargut. Sa herë desha të të preki çdo herë dhe në çdo kohë kam kuptuar se i kam gishtat e verbët sa që nuk shohin asgjë në dritë. Poezia e Zaplluzhës vjen me mendim të thellë poetik, me detaje prekëse e me figura të zgjedhura mjeshtërisht, duke e bërë librin e tij të një niveli të admirueshëm artistik I uroj librit udhëtim të këndshëm e të sigurt për në duart e lexuesve.

ADEM ZAPLLUZHA

ngrihej kundër censurimit të fjalës. Kur m'i vunë prangat e fjalëve unë këndova, isha rapsodi i cili mund të këndonte me vite të tëra pa përsëritur kurrë dy herë një këngë. Dhe në një poezi tjetër ai e shpalos lirshëm e pa droje shpirtin e tij çapkën që e dashuron jetën dhe lirinë e vet. Isha poeti më i shthurur në botë, putha sa herë më donte shpirti, me ëndrrat e ëndërruara nuk mund të krahasohej asnjë perëndi. Ndërsa në poezinë e goditur lirike “Si t'i prek flokët e tu kur bëhen erë”, autori tregon delikatesën e tij dhe finesën e vargut. Sa herë desha të të preki çdo herë dhe në çdo kohë kam kuptuar se i kam gishtat e verbët sa që nuk shohin asgjë në dritë. Poezia e Zaplluzhës vjen me mendim të thellë poetik, me detaje prekëse e me figura të zgjedhura mjeshtërisht, duke e bërë librin e tij të një niveli të admirueshëm artistik I uroj librit udhëtim të këndshëm e të sigurt për në duart e lexuesve.

8

Cikli i parë
Kur dënesin varret

KUR DËNESIN VARRET

Cikli i parë
Kur dënesin varret

9

ADEM ZAPLLUZHA

10

PASHË SE SI DËNESTE VARRI

Nuk më kujtohet
Se si dukej dikur ky rrap
Mbase i ngjante vdekjes sime
Ose kufoma ime u shëmbëllente
Drurëve të ngrirë në hapësirë

Asnjëherë nuk isha në gjendje
Të dalloj vegimin e erës
Që nga vdekja ime
Sa herë që e barta kufomën time
Mes duarve dukej si një çilimi i dehidruar

Për herë të parë atë vit
Pashë se si dëneste varri
Kurse një kufomë e kaltër dukej në qiell
Nga kafshimet e tërbuara të cerberëve
Si një copë mjegull e grisur

Qëndroja i stepur ose isha ulur kacule
Dhe i numëroja lopatat
Me dhe që binin mbi kurmin tim
Ende edhe sot më kujtohen çastet
Isha i vdekur
Ose dheu ishte një shi i imagjinuar

KUR DËNESIN VARRET

PASHË SE SI DËNESTE VARRI

Nuk më kujtohet
Se si dukej dikur ky rrap
Mbase i ngjante vdekjes sime
Ose kufoma ime u shëmbëllente
Drurëve të ngrirë në hapësirë

Asnjëherë nuk isha në gjendje
Të dalloj vegimin e erës
Që nga vdekja ime
Sa herë që e barta kufomën time
Mes duarve dukej si një çilimi i dehidruar

Për herë të parë atë vit
Pashë se si dëneste varri
Kurse një kufomë e kaltër dukej në qiell
Nga kafshimet e tërbuara të cerberëve
Si një copë mjegull e grisur

Qëndroja i stepur ose isha ulur kacule
Dhe i numëroja lopatat
Me dhe që binin mbi kurmin tim
Ende edhe sot më kujtohen çastet
Isha i vdekur
Ose dheu ishte një shi i imagjinuar

11

SOT MË NUK JENI NË GJENDJE

Më shikoni për së gjalli
Përse u besoni thashethemeve
Unë nuk jam i vdekur
Kurmi im doli nga zjarri
Doli si feniksi
Dhe kurrë më nuk e ndali fluturimin

Kurse ju të vdekurit e gjallë
Mendoni se kurmi i juaj
Mund të preket
Me sytë e vëngër të erës
Jo miqtë e mi të vdekur
Para shumë viteve i përpitë lopatat me dhe

Sot më nuk jeni në gjendje
Të dalloni vetveten
As duart e juaja të djegura
Shikoni atë lis
Që i shëmbëllen kufomës së juaj
Nën rrënjët e kalbura i përkundni ninullat

ADEM ZAPLLUZHA

SOT MË NUK JENI NË GJENDJE

Më shikoni për së gjalli
Përse u besoni thashethemeve
Unë nuk jam i vdekur
Kurmi im doli nga zjarri
Doli si feniksi
Dhe kurrë më nuk e ndali fluturimin

Kurse ju të vdekurit e gjallë
Mendoni se kurmi i juaj
Mund të preket
Me sytë e vëngër të erës
Jo miqtë e mi të vdekur
Para shumë viteve i përpitë lopatat me dhe

Sot më nuk jeni në gjendje
Të dalloni vetveten
As duart e juaja të djegura
Shikoni atë lis
Që i shëmbëllen kufomës së juaj
Nën rrënjët e kalbura i përkundni ninullat

12

KËNDONIN NJË ELEGJI PËR MESHËN

Më kujtohet vjeshta e vitit të shkuar
Një stinë e ngarkuar me vegime
Rinte mbështetur
Për stolin e vjetër te muranat e rrënuara
Ku për çdo ditë si një statujë
Qëndronte meshtari me një kryq të thyer

Sa herë që uleshin zogjtë
Mbi çatinë e kalbur të kishës
Dëgjohej si nga nëntoka
Një jehonë e lashtë e kambanës
Dëgjohej si një zë njeriu
I cili as nuk këndonte e as nuk qante

Në duart e zhubrosura të meshtarit
Lëvizte me një lëvizje alegorike
Temjani pa asnjë pikë vaji
Kurse kumritë e sëmura
Si në kor
Këndonin një elegji për meshën

KUR DËNESIN VARRET

KËNDONIN NJË ELEGJI PËR MESHËN

Më kujtohet vjeshta e vitit të shkuar
Një stinë e ngarkuar me vegime
Rinte mbështetur
Për stolin e vjetër te muranat e rrënuara
Ku për çdo ditë si një statujë
Qëndronte meshtari me një kryq të thyer

Sa herë që uleshin zogjtë
Mbi çatinë e kalbur të kishës
Dëgjohej si nga nëntoka
Një jehonë e lashtë e kambanës
Dëgjohej si një zë njeriu
I cili as nuk këndonte e as nuk qante

Në duart e zhubrosura të meshtarit
Lëvizte me një lëvizje alegorike
Temjani pa asnjë pikë vaji
Kurse kumritë e sëmura
Si në kor
Këndonin një elegji për meshën

13

VETËM ÇAFKAT E BARDHA QANIN ME NGASHËRIM

Më kujtohet si sot
Kur mbi qiellin e Kosovës
Fluturonin kukuvajkat e zeza
Fluturonin
Nëpër udhët e mjegullave të plagosura

Nuk kishte pikë shiu ato ditë
Disa lloje stërkalash të mykura
Që pështynte qielli i grisur
Nuk mund ta shuanin atë zjarrin
E ndezur para njëqind viteve

Më duket se atë ditë
Nuk pati asnjë rrugëdalje
Drita në fund të tunelit
Kishte mbetur diku në mes të udhës
Vetëm çafkat e bardha qanin me ngashërim

ADEM ZAPLLUZHA

VETËM ÇAFKAT E BARDHA QANIN ME NGASHËRIM

Më kujtohet si sot
Kur mbi qiellin e Kosovës
Fluturonin kukuvajkat e zeza
Fluturonin
Nëpër udhët e mjegullave të plagosura

Nuk kishte pikë shiu ato ditë
Disa lloje stërkalash të mykura
Që pështynte qielli i grisur
Nuk mund ta shuanin atë zjarrin
E ndezur para njëqind viteve

Më duket se atë ditë
Nuk pati asnjë rrugëdalje
Drita në fund të tunelit
Kishte mbetur diku në mes të udhës
Vetëm çafkat e bardha qanin me ngashërim

14

NË ANËN TJETËR TË DYNJASË

Mos u frikoni ju
Që jeni në rreshtat e fundit
Të procesionit tim
Do të keni ende kohë të zëni trenin
Për në qivurin që ju pret përtej varreev

Unë sot ndoshta u linda
Mbase edhe vdiqa
Lindja nga vdekjen nuk dallojnë aspak
Sepse në çastin kur i hap sytë njeriu
Para tij paraqiten vegimet e vdekjes

Përse atëherë të frikoheni
Më mirë të vdisni njëherë
Se sa që jeni duke vdekur çdo ditë
Shikoni kurmin tim
Me sa krenari i afrohet tokës mëmë

Shikoni se si duket njeriun i vdekur
Përse kjo frikë e pa definuar
Asnjë ndryshim meteorologjik
Nuk ju pret përtej atyre hijeve
Ose në anën tjetër të dynjasë

KUR DËNESIN VARRET

NË ANËN TJETËR TË DYNJASË

Mos u frikoni ju
Që jeni në rreshtat e fundit
Të procesionit tim
Do të keni ende kohë të zëni trenin
Për në qivurin që ju pret përtej varreev

Unë sot ndoshta u linda
Mbase edhe vdiqa
Lindja nga vdekjen nuk dallojnë aspak
Sepse në çastin kur i hap sytë njeriu
Para tij paraqiten vegimet e vdekjes

Përse atëherë të frikoheni
Më mirë të vdisni njëherë
Se sa që jeni duke vdekur çdo ditë
Shikoni kurmin tim
Me sa krenari i afrohet tokës mëmë

Shikoni se si duket njeriun i vdekur
Përse kjo frikë e pa definuar
Asnjë ndryshim meteorologjik
Nuk ju pret përtej atyre hijeve
Ose në anën tjetër të dynjasë

15

ATJE KU DIELLI SURREALIST I LËSHON RREZET

Te ato rrape të djegura
Më leni një copë tokë
Më leni
Ta ndërtoj shtëpinë time

Unë tokën time e shita
Viteve pesëdhjeta
E shita
Se doja të shkoj në Anadolli

Më thoshin hoxhallarët
Janë disa hije plepash
Ku mund të gjejmë një grusht dhe
Mund të gjejmë ta ngopim syrin e uritur

Ja që sot u ktheva
Të gjej një copë tokë të shkriftë
E të më varrosin te rrapet
Atje ku dielli surrealist i lëshon rrezet

ADEM ZAPLLUZHA

ATJE KU DIELLI SURREALIST I LËSHON RREZET

Te ato rrape të djegura
Më leni një copë tokë
Më leni
Ta ndërtoj shtëpinë time

Unë tokën time e shita
Viteve pesëdhjeta
E shita
Se doja të shkoj në Anadolli

Më thoshin hoxhallarët
Janë disa hije plepash
Ku mund të gjejmë një grusht dhe
Mund të gjejmë ta ngopim syrin e uritur

Ja që sot u ktheva
Të gjej një copë tokë të shkriftë
E të më varrosin te rrapet
Atje ku dielli surrealist i lëshon rrezet

16

NJERËZIT KËTU NUK KUPTOJNË

Sa herë që më shohin
Duke bredhur
Aleve të qytetit fantazmë
Mendojnë se jam një kufomë
Pa jetë dhe shpirt

Njerëzit këtu nuk kuptojnë
Se edhe kufomat jetojnë
Prej një çasti në çastin tjetër
I mbledhin tasat e konservave
Ose ushqehen me konserva të skaduara

Po ne të gjithë jemi kufoma
More zoti ju vraftë
Ecim si somnambul udhëve
Të trasuar nga disa alien
Nga ata që nuk i njohin malet

Atje këpusim një rrënjë hithi
Diku me poshtë
Shkulim një grusht lakre të kuqe
Sa për ta mbajtur shpirtin gjallë
I shkulim edhe mushkrit tona

KUR DËNESIN VARRET

NJERËZIT KËTU NUK KUPTOJNË

Sa herë që më shohin
Duke bredhur
Aleve të qytetit fantazmë
Mendojnë se jam një kufomë
Pa jetë dhe shpirt

Njerëzit këtu nuk kuptojnë
Se edhe kufomat jetojnë
Prej një çasti në çastin tjetër
I mbledhin tasat e konservave
Ose ushqehen me konserva të skaduara

Po ne të gjithë jemi kufoma
More zoti ju vraftë
Ecim si somnambul udhëve
Të trasuar nga disa alien
Nga ata që nuk i njohin malet

Atje këpusim një rrënjë hithi
Diku me poshtë
Shkulim një grusht lakre të kuqe
Sa për ta mbajtur shpirtin gjallë
I shkulim edhe mushkrit tona

17

SA ORA NDRYSHON KOHA

Për befasinë time the të gjithëve
Shoh disa lloje njerëzish
Të gëzuar dhe të pikëlluar
Kjo vdekje më bëri më të mençur
T'i dalloj njerëzit
Prej atyre të tjerëve

Në shpirtin e dikujt
Dëgjoheshin tingujt e një muzike
Kurse te dikush tjetër
Me një pikëllim i thellë
Lëshonte rrënjë
Mbi kufomën time të gjallë

Të tillë jemi ne
Tek e fundit jemi njerëz
Dimë të gëzohemi dhe të pikëllohemi
Sa ora ndryshon koha
Në mendjen e destabilizuar të njeriut
Sa ora mbi kokat tona
Zbresin mjegullat e zeza

ADEM ZAPLLUZHA

SA ORA NDRYSHON KOHA

Për befasinë time the të gjithëve
Shoh disa lloje njerëzish
Të gëzuar dhe të pikëlluar
Kjo vdekje më bëri më të mençur
T'i dalloj njerëzit
Prej atyre të tjerëve

Në shpirtin e dikujt
Dëgjoheshin tingujt e një muzike
Kurse te dikush tjetër
Me një pikëllim i thellë
Lëshonte rrënjë
Mbi kufomën time të gjallë

Të tillë jemi ne
Tek e fundit jemi njerëz
Dimë të gëzohemi dhe të pikëllohemi
Sa ora ndryshon koha
Në mendjen e destabilizuar të njeriut
Sa ora mbi kokat tona
Zbresin mjegullat e zeza

18

THUA SE KANË VDEKUR ATA E JO UNË

Dje askush nuk kishte mbetur
Nëpër rrugicat e ngushta të qytetit
Gjysma e njerëzve
Kishin dalë në piknik
Kurse gjysma tjetër
Kinse vajtonnin te varret

Unë shikoja si i dehur
Shikoja procesionin kah kalamendej
Askush asnjë lule
Nuk mbante nëpër duar
Ishin tharë edhe shpirtrat e tyre

Sa për sy e faqe
Mbanin nga një qiri në dorë
Por asnjëri se kishte ndezur
Ecnin me hapa të rënda
Thua se kanë vdekur ata e jo unë

KUR DËNESIN VARRET

THUA SE KANË VDEKUR ATA E JO UNË

Dje askush nuk kishte mbetur
Nëpër rrugicat e ngushta të qytetit
Gjysma e njerëzve
Kishin dalë në piknik
Kurse gjysma tjetër
Kinse vajtonnin te varret

Unë shikoja si i dehur
Shikoja procesionin kah kalamendej
Askush asnjë lule
Nuk mbante nëpër duar
Ishin tharë edhe shpirtrat e tyre

Sa për sy e faqe
Mbanin nga një qiri në dorë
Por asnjëri se kishte ndezur
Ecnin me hapa të rënda
Thua se kanë vdekur ata e jo unë

19

PASKAN LINDUR POSAÇËRISHT PËR MUA

Gati se u bëra me vajë
E bëra zemrën guri
Përse të qaj kur mund të këndoj
Le të qajnë ata
Që i kanë ngarkuar qeret me mallkim

Unë jam tepër i rehatshëm
Ky qivur qenka ndërtuar
Për eshtrat e mi me rakitik
E paskan gdhendur
Nga rrapi i atdheut tim

Më thoni a thua kam vallë
Ndonjë arsye përse të qaj
Kjo ditë e këto çaste
Paskan lindur posaçërisht për mua
Dhe varrimin tim madhështor

ADEM ZAPLLUZHA

PASKAN LINDUR POSAÇËRISHT PËR MUA

Gati se u bëra me vajë
E bëra zemrën guri
Përse të qaj kur mund të këndoj
Le të qajnë ata
Që i kanë ngarkuar qeret me mallkim

Unë jam tepër i rehatshëm
Ky qivur qenka ndërtuar
Për eshtrat e mi me rakitik
E paskan gdhendur
Nga rrapi i atdheut tim

Më thoni a thua kam vallë
Ndonjë arsye përse të qaj
Kjo ditë e këto çaste
Paskan lindur posaçërisht për mua
Dhe varrimin tim madhështor

20

TË PUSHOJNË SI I KA HIJE NJË TË VDEKURI

Kam lënë një amanet me gojë
Le të më varrosin
Mu atje ku i kanë varret
Etërit e mi
Ku me shekuj pushojnë eshtrat
E një kombi krenar

E njoh historinë e këtij vendi
Sa e sa herë pushtetet e huaja
Na i lëruan varret
E ne mbetëm si gjithmonë
Pa varr e nishan
Mbetëm si qirinjtë e ndezur në hapësirë

Ju lutem më varrosni mu atje
Ku ju thashë
Ku janë gjyshërit e mi dardanë
Dua që eshtrat e mi të dërmuar
Të pushojnë në qetësi në këto anë
Të pushojnë si i ka hije një të vdekuri

KUR DËNESIN VARRET

TË PUSHOJNË SI I KA HIJE NJË TË VDEKURI

Kam lënë një amanet me gojë
Le të më varrosin
Mu atje ku i kanë varret
Etërit e mi
Ku me shekuj pushojnë eshtrat
E një kombi krenar

E njoh historinë e këtij vendi
Sa e sa herë pushtetet e huaja
Na i lëruan varret
E ne mbetëm si gjithmonë
Pa varr e nishan
Mbetëm si qirinjtë e ndezur në hapësirë

Ju lutem më varrosni mu atje
Ku ju thashë
Ku janë gjyshërit e mi dardanë
Dua që eshtrat e mi të dërmuar
Të pushojnë në qetësi në këto anë
Të pushojnë si i ka hije një të vdekuri

21

KUR DËNESIN VARRET

Dielli ndalet kur dënesin varret
Ndalet
Në shenjë respekti për të vdekurit
Ndalen edhe lopët e diellit
Nuk dalin në kullosë

Nëse ngjan të jetë natë
Flokët i shkul hëna
Vajton si nëna
Për të vetmin djalë
Kur dënesin varret dhe rrapet

Ju thashë se kur dënesin varret
Dielli e humb itinerarin
Ndoshta as të nesërmen nuk lind
Pret ndonjë tjetër nesër
Ta paraqitet si dhëndëri në gjerdek

Kur dënesin varret
Njerëzit heshtin
Heshtin
Se nuk kanë guxim të paraqiten
Pran altarit të mëkateve

ADEM ZAPLLUZHA

KUR DËNESIN VARRET

Dielli ndalet kur dënesin varret
Ndalet
Në shenjë respekti për të vdekurit
Ndalen edhe lopët e diellit
Nuk dalin në kullosë

Nëse ngjan të jetë natë
Flokët i shkul hëna
Vajton si nëna
Për të vetmin djalë
Kur dënesin varret dhe rrapet

Ju thashë se kur dënesin varret
Dielli e humb itinerarin
Ndoshta as të nesërmen nuk lind
Pret ndonjë tjetër nesër
Ta paraqitet si dhëndëri në gjerdek

Kur dënesin varret
Njerëzit heshtin
Heshtin
Se nuk kanë guxim të paraqiten
Pran altarit të mëkateve

22

E CILA NUK KA ASNJË NGJYRË

Nuk di më ku më mbetën miqtë
Në këtë botë
Nuk shihen askund
As në botën tjetër s'janë
Thua se i përpiu dheu i zi

Në varre nuk shoh njeri
Përpos çafkave
Dhe korbave të bardha
Asnjë zog tjetër lajmëtar
Nuk fluturon mbi kujtimin tim

Më kanë mbetur si relikte
Vetëm kartolinat e verdha
Dhe mjegullat mbi kokë
Kurse krakëllimat e qiellit
Asnjë çast nuk pushojnë

Askush më nuk kupton
A thua vallë i thonë kësaj
Vdekje e zezë ose e bardhë
Por gjithsesi është një vdekje
E cila nuk ka asnjë ngjyrë

KUR DËNESIN VARRET

E CILA NUK KA ASNJË NGJYRË

Nuk di më ku më mbetën miqtë
Në këtë botë
Nuk shihen askund
As në botën tjetër s'janë
Thua se i përpiu dheu i zi

Në varre nuk shoh njeri
Përpos çafkave
Dhe korbave të bardha
Asnjë zog tjetër lajmëtar
Nuk fluturon mbi kujtimin tim

Më kanë mbetur si relikte
Vetëm kartolinat e verdha
Dhe mjegullat mbi kokë
Kurse krakëllimat e qiellit
Asnjë çast nuk pushojnë

Askush më nuk kupton
A thua vallë i thonë kësaj
Vdekje e zezë ose e bardhë
Por gjithsesi është një vdekje
E cila nuk ka asnjë ngjyrë

23

JA PRA SHIKONI SE SI ECËN SKELETI

Kur më pyesin në kalim e sipër si je
Kam vetëm një përgjigje
Ku ta di unë si jam
Mos keni parë vallë
Se kufomat dinë të përgjigjen

Jam mu ashtu siç dukem
Një njeri që ecën rrugëve si psikopat
Pa asnjë të ardhme
Me perëndimin e diellit
E kaluara tinëzisht më ka vdekur

Ja pra shikoni se si ecën skeleti
Dëgjoni kërcitjen e eshtrave
U ngjajnë arabave të palyera me peshkve
Nga gjymtyrët e nakatosura
Pikon një gjak i zi

Askush përpos meje
Nuk i dëgjoi mbrëmë të lehurat
E cerberëve të egër
I dëgjova vetëm unë sepse të vdekurit
I kanë shqisat e të dëgjuarit më të përsosura

ADEM ZAPLLUZHA

JA PRA SHIKONI SE SI ECËN SKELETI

Kur më pyesin në kalim e sipër si je
Kam vetëm një përgjigje
Ku ta di unë si jam
Mos keni parë vallë
Se kufomat dinë të përgjigjen

Jam mu ashtu siç dukem
Një njeri që ecën rrugëve si psikopat
Pa asnjë të ardhme
Me perëndimin e diellit
E kaluara tinëzisht më ka vdekur

Ja pra shikoni se si ecën skeleti
Dëgjoni kërcitjen e eshtrave
U ngjajnë arabave të palyera me peshkve
Nga gjymtyrët e nakatosura
Pikon një gjak i zi

Askush përpos meje
Nuk i dëgjoi mbrëmë të lehurat
E cerberëve të egër
I dëgjova vetëm unë sepse të vdekurit
I kanë shqisat e të dëgjuarit më të përsosura

24

E NESËRMJA BREDH RRUGËVE

Kur u dehën gurët e varreve
Askush nuk kuptoi
Se në emër të kujt
Varrtarët ngritën dolli

Ndoshta papandehur vdiq atdheu
Edhe pakëz frymëmarrje
U kishte mbetur lisave gjysmë të vdekur
Nën hijet e rrapeve dënesnin zogjtë

Nuk dua të them më asnjë fjalë
Sepse edhe fjalët më kanë vdekur
Kjo mistikë e shthurur e lisave
Po i shtrydhë të gjitha kujtimet

Çfarë na mbeti nga e djeshmja
E çfarë do të mbetet nga e sotmja
Kurse e nesërmja bredh rrugëve
Si një kufomë e ngordhur

KUR DËNESIN VARRET

E NESËRMJA BREDH RRUGËVE

Kur u dehën gurët e varreve
Askush nuk kuptoi
Se në emër të kujt
Varrtarët ngritën dolli

Ndoshta papandehur vdiq atdheu
Edhe pakëz frymëmarrje
U kishte mbetur lisave gjysmë të vdekur
Nën hijet e rrapeve dënesnin zogjtë

Nuk dua të them më asnjë fjalë
Sepse edhe fjalët më kanë vdekur
Kjo mistikë e shthurur e lisave
Po i shtrydhë të gjitha kujtimet

Çfarë na mbeti nga e djeshmja
E çfarë do të mbetet nga e sotmja
Kurse e nesërmja bredh rrugëve
Si një kufomë e ngordhur

25

MOS JAM VALLË ALIEN

O ju përgjëroj si perëndinë
Më tregoni pa hile dhe lajka
Se kush isha dje
Dhe kush jam sot
Cili djall hyri tinëzisht në shpirt

Jam ose nuk jam njeri
Çfarë gjaku mistik rrjedh
Nga damarët e mi të ndryshkur
Kush ishin ata që erdhën
Dhe na i dhunuan pjergullat pa u pjekur

Sot vetëm sot po ju lutem
Kam një lutje sa njerëzore
Po aq edhe jonjerëzore
Më tregoni nga cili planet
Pikuan gjymtyrët e mi

Mos jam vallë alien
Dhe nuk e njoh gjuhën e juaj
Por unë di se nga cili planet erdhët
Dhe i thyet gjymtyrët e ëndrrave
I thyet për të mbetur gjallë

ADEM ZAPLLUZHA

MOS JAM VALLË ALIEN

O ju përgjëroj si perëndinë
Më tregoni pa hile dhe lajka
Se kush isha dje
Dhe kush jam sot
Cili djall hyri tinëzisht në shpirt

Jam ose nuk jam njeri
Çfarë gjaku mistik rrjedh
Nga damarët e mi të ndryshkur
Kush ishin ata që erdhën
Dhe na i dhunuan pjergullat pa u pjekur

Sot vetëm sot po ju lutem
Kam një lutje sa njerëzore
Po aq edhe jonjerëzore
Më tregoni nga cili planet
Pikuan gjymtyrët e mi

Mos jam vallë alien
Dhe nuk e njoh gjuhën e juaj
Por unë di se nga cili planet erdhët
Dhe i thyet gjymtyrët e ëndrrave
I thyet për të mbetur gjallë

26

TË VDESIN QYQET

Të hapura ose të mbyllura
Varret presin gjithmonë
Presin si gratë
Te dritaret me perde gjysmë të lëshuara

Ndonjëherë kanë mall
Për ndonjë serenatë
Ose për ndonjë vigmë njeriu
Secili pret te varri kryqin e vet

Unë njëmijë vjet prita lirinë
Atdheu shpëtimin e shumëpritur
Pritëm në duet
Të çojmë një dolli për të vdekurit

Dje erdhi çasti vendimtar
Të vdesin qyqet
Nuk bëzani asnjë kukuvajkë
Nëpër majat e lisave këndonte mali

KUR DËNESIN VARRET

TË VDESIN QYQET

Të hapura ose të mbyllura
Varret presin gjithmonë
Presin si gratë
Te dritaret me perde gjysmë të lëshuara

Ndonjëherë kanë mall
Për ndonjë serenatë
Ose për ndonjë vigmë njeriu
Secili pret te varri kryqin e vet

Unë njëmijë vjet prita lirinë
Atdheu shpëtimin e shumëpritur
Pritëm në duet
Të çojmë një dolli për të vdekurit

Dje erdhi çasti vendimtar
Të vdesin qyqet
Nuk bëzani asnjë kukuvajkë
Nëpër majat e lisave këndonte mali

27

KU S'MBINË ASNJË FIJE BARI

Në jetën time të begatë
Kam parë varre
Të mbuluar me lule
Dhe varre pa fije bari të thatë

Asnjë pemë nuk mbiu
Në varrin e tradhtarit
Kurse ngjau e kundërta
Mbi atë të atdhetarit

Kam parë varre pa gur
Të panjohur anonim
U tretën ashtu siç vepruan
Pa lënë asnjë shenjë për identifikim

Varr mbi gur të murrmë
Gur të zi te varri
Varr të lënë shkretë e të tharë
Ku s'mbinë asnjë fije bari

ADEM ZAPLLUZHA

KU S'MBINË ASNJË FIJE BARI

Në jetën time të begatë
Kam parë varre
Të mbuluar me lule
Dhe varre pa fije bari të thatë

Asnjë pemë nuk mbiu
Në varrin e tradhtarit
Kurse ngjau e kundërta
Mbi atë të atdhetarit

Kam parë varre pa gur
Të panjohur anonim
U tretën ashtu siç vepruan
Pa lënë asnjë shenjë për identifikim

Varr mbi gur të murrmë
Gur të zi te varri
Varr të lënë shkretë e të tharë
Ku s'mbinë asnjë fije bari

28

FRYJ E MËKATET MOS UA FAL

Nëpër një fërfëllizë
Era frynte me trishtim
Frynte mbi varrin tim
Një stuhi e fortë me tërbim

Shkundej bari nga tërmeti
Tërmet mbi dhe tërmet nën dhe
Vaj halli i horrave
Faqezinjtë do mbulohen nën dhe

Fryj moj stuhi mbi varre
E mos u ndal
Fryj stuhishëm aq sa mundesh
Fryj e mëkatet mos ua fal

Le të dridhet kjo tokë e mjerë
Të ketë turp në zemër kë e mbanë
Fryj e fryj sa më trishtueshëm
Mallko gjakun mallkoi babë e nënë

KUR DËNESIN VARRET

FRYJ E MËKATET MOS UA FAL

Nëpër një fërfëllizë
Era frynte me trishtim
Frynte mbi varrin tim
Një stuhi e fortë me tërbim

Shkundej bari nga tërmeti
Tërmet mbi dhe tërmet nën dhe
Vaj halli i horrave
Faqezinjtë do mbulohen nën dhe

Fryj moj stuhi mbi varre
E mos u ndal
Fryj stuhishëm aq sa mundesh
Fryj e mëkatet mos ua fal

Le të dridhet kjo tokë e mjerë
Të ketë turp në zemër kë e mbanë
Fryj e fryj sa më trishtueshëm
Mallko gjakun mallkoi babë e nënë

29

PROSTITUTA E PEDOFIL

Ja që varret i kemi në hall të madh
Herë dënesin për njerëzit e mirë
E herë për tradhtarë
Eshtrat e të cilëve domosdo
Në zjarr duhet me i kallë

Nëse është ditë ose natë
Pështymën mos kurse në asnjë mënyrë
Ndalu e pështyj në surrat
Se për tradhtarin
Nuk gjen dot asnjë mënyrë

Ah këto varre çfarë nuk durojnë
Dezertorë horra pisa pa profil
E njerëz me njëqind fytyra
Prostituta e pedofil
Sa që prej tyre turpërohet pasqyra

ADEM ZAPLLUZHA

PROSTITUTA E PEDOFIL

Ja që varret i kemi në hall të madh
Herë dënesin për njerëzit e mirë
E herë për tradhtarë
Eshtrat e të cilëve domosdo
Në zjarr duhet me i kallë

Nëse është ditë ose natë
Pështymën mos kurse në asnjë mënyrë
Ndalu e pështyj në surrat
Se për tradhtarin
Nuk gjen dot asnjë mënyrë

Ah këto varre çfarë nuk durojnë
Dezertorë horra pisa pa profil
E njerëz me njëqind fytyra
Prostituta e pedofil
Sa që prej tyre turpërohet pasqyra

30

TË DËGJOJ SE SI BËRTET

Shpesh thotë se pendohet
Një varrtar
Kur varros kriminel
Horra
Dhe burra tradhtar

Tregon me ngashërim
Se si dheu qanë
Kur mbulon me dhe të Kosovës
Personin
Që s’respektoi babë as nënë

Çfarë nuk duron
Kjo tokë e mjerë dhe e shkretë
Ah të kishte një zë vigan
Të dëgjoj se si bërtet
Kur në shpirtin e saj varroset një tiran

KUR DËNESIN VARRET

TË DËGJOJ SE SI BËRTET

Shpesh thotë se pendohet
Një varrtar
Kur varros kriminel
Horra
Dhe burra tradhtar

Tregon me ngashërim
Se si dheu qanë
Kur mbulon me dhe të Kosovës
Personin
Që s’respektoi babë as nënë

Çfarë nuk duron
Kjo tokë e mjerë dhe e shkretë
Ah të kishte një zë vigan
Të dëgjoj se si bërtet
Kur në shpirtin e saj varroset një tiran

31

NËN NJË MANË TË EGËR

Era e verdhë
Kishte pamjen e një varri
Kurse flutura
Dukej si një zog shtegtar
Dimri më nuk ishte dimër
As behari behar

Nën një manë të egër
Si pema e shpresës
Që pritnim dikur
Rritej një gur varri
Dy zogj të kaltër si zarfet
Shikonin se si fishkej bari

Fiku i egër me vite të tëra
Nuk dha asnjë kokërr
Nga frytet e saja
Rritej si lulja mbi një gur
Një ditë prej ditësh ra murtaja
Dhe në mjedis të varreve u ngrit një mur

ADEM ZAPLLUZHA

NËN NJË MANË TË EGËR

Era e verdhë
Kishte pamjen e një varri
Kurse flutura
Dukej si një zog shtegtar
Dimri më nuk ishte dimër
As behari behar

Nën një manë të egër
Si pema e shpresës
Që pritnim dikur
Rritej një gur varri
Dy zogj të kaltër si zarfet
Shikonin se si fishkej bari

Fiku i egër me vite të tëra
Nuk dha asnjë kokërr
Nga frytet e saja
Rritej si lulja mbi një gur
Një ditë prej ditësh ra murtaja
Dhe në mjedis të varreve u ngrit një mur

32

MBETA PA ASNJË PËRGJIGJE

Askush nuk erdhi këtu
për pushimet verore
Për çudi njerëzit vdisnin dimrit
Mbase toka
Kishte një ngrohtësi alegorike

Vinin jo me dëshirën e vet
I sjellin të tjerët
Mendonin se në dimër
Mbi tokë ngrihen pemët
Kurse rrënjët mbesin të paprekura

Më rastisi të bisedoj me rrënjët
Nga njëqind pyetje
Mbeta pa asnjë përgjigje
Si guri ose më mirë me thënë si druri
Njëherë e përgjithmonë heshtën varret

Kam mbetur si një kërcu i stepur
Shikoja strallin e murrmë
Në të njëjtën mënyrë
Se si më shikonin mua gurët
Vetë varret dukeshin se ishin lakuriqe

KUR DËNESIN VARRET

MBETA PA ASNJË PËRGJIGJE

Askush nuk erdhi këtu
për pushimet verore
Për çudi njerëzit vdisnin dimrit
Mbase toka
Kishte një ngrohtësi alegorike

Vinin jo me dëshirën e vet
I sjellin të tjerët
Mendonin se në dimër
Mbi tokë ngrihen pemët
Kurse rrënjët mbesin të paprekura

Më rastisi të bisedoj me rrënjët
Nga njëqind pyetje
Mbeta pa asnjë përgjigje
Si guri ose më mirë me thënë si druri
Njëherë e përgjithmonë heshtën varret

Kam mbetur si një kërcu i stepur
Shikoja strallin e murrmë
Në të njëjtën mënyrë
Se si më shikonin mua gurët
Vetë varret dukeshin se ishin lakuriqe

33

KUR TË PUSHOJ NDONJË UDHËTAR

Kur të vdes
Më hidhni sipër meje
Dy lopate dhe
Dhe një kaçubë mbillni
Te koka ime
Të ketë se ku të këndoj qyqja

Nëse ndodh stina e verës
Mund të hidhni
Dy grushte rërë
Se sa shumë kam etje
Për njelmësinë e Adriatikut
Këtë e dinë vetëm ullinjtë

Nëse ngjan të vdes në mal
Te koka dhe këmbët e mi
Mbillni nga një rrap
Kur të pushoj te varrit tim
Ndonjë udhëtar i panjohur
Ndoshta mi reciton vargjet e Fishtës
Prishtinë, 13 nëntor 2018

ADEM ZAPLLUZHA

KUR TË PUSHOJ NDONJË UDHËTAR

Kur të vdes
Më hidhni sipër meje
Dy lopate dhe
Dhe një kaçubë mbillni
Te koka ime
Të ketë se ku të këndoj qyqja

Nëse ndodh stina e verës
Mund të hidhni
Dy grushte rërë
Se sa shumë kam etje
Për njelmësinë e Adriatikut
Këtë e dinë vetëm ullinjtë

Nëse ngjan të vdes në mal
Te koka dhe këmbët e mi
Mbillni nga një rrap
Kur të pushoj te varrit tim
Ndonjë udhëtar i panjohur
Ndoshta mi reciton vargjet e Fishtës
Prishtinë, 13 nëntor 2018

34

Cikli i dytë
Përpos një vegimi të largët

KUR DËNESIN VARRET

Cikli i dytë
Përpos një vegimi të largët

35

ADEM ZAPLLUZHA

36

MBETËN SI RELIKTET E NJË LASHTËSIE

I harruam rrugët
Kujtimet mbetën diku pas shpine
Ishim ose ka qenë dashtë të jemi
Më syhapur
Kur i shkelëm udhët e pakalueshme

Më kujtohet se ishte koha e harresës
Për një kokërr misri
Ngjante që bëheshin shtatë gjaqe
Dhe për shtatë vjet këmishët
S'largoheshin nga gardhet e kalbura

Ne deshëm ose jo por i harruam
Udhët tona
Asnjëherë nuk menduam
Për itineraret e kthimeve
Me vetëdije ose pa të e zbrazëm atdheun

Kjo tokë u bë atdheu i askujt
Nga të katër anët e dynjasë
Erdhën djajtë dhe e lodruan sa dhe si deshën
Varret mbetën peng i vetmisë
Mbetën si reliktet e një lashtësie

KUR DËNESIN VARRET

MBETËN SI RELIKTET E NJË LASHTËSIE

I harruam rrugët
Kujtimet mbetën diku pas shpine
Ishim ose ka qenë dashtë të jemi
Më syhapur
Kur i shkelëm udhët e pakalueshme

Më kujtohet se ishte koha e harresës
Për një kokërr misri
Ngjante që bëheshin shtatë gjaqe
Dhe për shtatë vjet këmishët
S'largoheshin nga gardhet e kalbura

Ne deshëm ose jo por i harruam
Udhët tona
Asnjëherë nuk menduam
Për itineraret e kthimeve
Me vetëdije ose pa të e zbrazëm atdheun

Kjo tokë u bë atdheu i askujt
Nga të katër anët e dynjasë
Erdhën djajtë dhe e lodruan sa dhe si deshën
Varret mbetën peng i vetmisë
Mbetën si reliktet e një lashtësie

37

TE DY RRASAT DY NJOLLA TË ZEZA GJAKU

Mbi një mermer të kuq Kosove
Dy njolla të zeza
Mbase është tharë gjaku i drurëve
Ose vetë njeriu vizatoi historinë
E një tragjedie te rrasat e bardha

Diçka ishte mes ahengut dhe tragjedisë
Por ishte dhe s’mund të zhbëhet
Ende sot përmendin pleqtë
Se te dy njollat
U shkrua një histori gojore

U shkrua dhe kurrë më nuk e harroi askush
Sa herë që kalojmë andej pari
I shohim disa silueta të zeza
Herë largohen si hijet
E herë vijnë si mjegullat e plumbta

Te dy njollat e zeza mbi dy copë mermeri
Dy tregime si fantazmë sillen sot
Sillen si lugetërit
Në imagjinatën e njeriut
Te dy rrasat dy njolla të zeza gjaku

ADEM ZAPLLUZHA

TE DY RRASAT DY NJOLLA TË ZEZA GJAKU

Mbi një mermer të kuq Kosove
Dy njolla të zeza
Mbase është tharë gjaku i drurëve
Ose vetë njeriu vizatoi historinë
E një tragjedie te rrasat e bardha

Diçka ishte mes ahengut dhe tragjedisë
Por ishte dhe s’mund të zhbëhet
Ende sot përmendin pleqtë
Se te dy njollat
U shkrua një histori gojore

U shkrua dhe kurrë më nuk e harroi askush
Sa herë që kalojmë andej pari
I shohim disa silueta të zeza
Herë largohen si hijet
E herë vijnë si mjegullat e plumbta

Te dy njollat e zeza mbi dy copë mermeri
Dy tregime si fantazmë sillen sot
Sillen si lugetërit
Në imagjinatën e njeriut
Te dy rrasat dy njolla të zeza gjaku

38

PËRPOS NJË VEGIM I LARGËT

Nëse trishtohen gjërat rreth teje
Ti mos nguro
Edhe era është e trishtuar
Kur kalon nëpër të pesë shqisat e tua

Të kujtohet pema e tharë
Se si notonte mbi lumin e vdekur
Ishin duart tona të lodhura
Duke llamburitur në anijen e kujtesës

Më duket se na shkeli koha
Ose ne pa dashje shkelëm çdo gjë
Që mund të quhej kujtim
I shkelëm çastet më sublime të hijeve

Kujtesa nuk është asgjë tjetër
Përpos një vegim i largët
I cili kur zbret nga lashtësia
Duket si kokrra e pluhurit në miniaturë

KUR DËNESIN VARRET

PËRPOS NJË VEGIM I LARGËT

Nëse trishtohen gjërat rreth teje
Ti mos nguro
Edhe era është e trishtuar
Kur kalon nëpër të pesë shqisat e tua

Të kujtohet pema e tharë
Se si notonte mbi lumin e vdekur
Ishin duart tona të lodhura
Duke llamburitur në anijen e kujtesës

Më duket se na shkeli koha
Ose ne pa dashje shkelëm çdo gjë
Që mund të quhej kujtim
I shkelëm çastet më sublime të hijeve

Kujtesa nuk është asgjë tjetër
Përpos një vegim i largët
I cili kur zbret nga lashtësia
Duket si kokrra e pluhurit në miniaturë

39

KALËRONIM SI KUAJT E DRUNJTË

Në lagjen tonë gjithmonë gratë
Dukeshin të veshura
Në të zeza
Me bucela në shpinë kalonin kokulur
Kalonin pranë muranave të kishës

Ndonjëra belbëzonte ndonjë lutje fetare
Ose ndonjë tjetër e moshuar
Nuk e lodhte kokën për psalmet
Që këndoheshin vetëm njëherë në vit
Kur ishin festat e kërshëndellave

Kur pyetnim përse këto pamje të ngrysura
Asnjëra asnjëherë
Nuk na thoshte asnjë fjalë
Përpos na thoshin
Më mirë shikoni punët e juaja

Kurse ne nga inati u hipnin fshesave
Dhe i kalëronim tërë ditën
Kalëronim si kuajt e drunjtë
Deri vonë në mbrëmje
E gjyshet tona sërish merakoseshin për ne

ADEM ZAPLLUZHA

KALËRONIM SI KUAJT E DRUNJTË

Në lagjen tonë gjithmonë gratë
Dukeshin të veshura
Në të zeza
Me bucela në shpinë kalonin kokulur
Kalonin pranë muranave të kishës

Ndonjëra belbëzonte ndonjë lutje fetare
Ose ndonjë tjetër e moshuar
Nuk e lodhte kokën për psalmet
Që këndoheshin vetëm njëherë në vit
Kur ishin festat e kërshëndellave

Kur pyetnim përse këto pamje të ngrysura
Asnjëra asnjëherë
Nuk na thoshte asnjë fjalë
Përpos na thoshin
Më mirë shikoni punët e juaja

Kurse ne nga inati u hipnin fshesave
Dhe i kalëronim tërë ditën
Kalëronim si kuajt e drunjtë
Deri vonë në mbrëmje
E gjyshet tona sërish merakoseshin për ne

40

TË THASHË NËSE TI NUK VJEN SONTE

Nëse ti nuk vjen sonte
Çfarë të bëj me vetminë time
Më janë lodhur duart
Si mund ta përqafoj fotografinë
E varur në murin e kujtesës

Më duket se kaluan dyqind vjet
Pa e dëgjuar zërin e erës
Ajo luante me flokët e mi
Si macja me miun
Andaj më pëlqejnë duart e saja

Ta pata thënë me një rast
Se era u lind në shpirtin e Eolit
Dhe kurrë nuk u shndërrua
Në një statujë të mermertë
Ku mund t'i prekja duart e brishta

Po të them nëse ti nuk vjen sonte
Nuk më duhet askush tjetër
U mësova me vetminë time
Nga xhepat e së cilës i nxjerri
Të gjitha kujtimet e së kaluarës

KUR DËNESIN VARRET

TË THASHË NËSE TI NUK VJEN SONTE

Nëse ti nuk vjen sonte
Çfarë të bëj me vetminë time
Më janë lodhur duart
Si mund ta përqafoj fotografinë
E varur në murin e kujtesës

Më duket se kaluan dyqind vjet
Pa e dëgjuar zërin e erës
Ajo luante me flokët e mi
Si macja me miun
Andaj më pëlqejnë duart e saja

Ta pata thënë me një rast
Se era u lind në shpirtin e Eolit
Dhe kurrë nuk u shndërrua
Në një statujë të mermertë
Ku mund t'i prekja duart e brishta

Po të them nëse ti nuk vjen sonte
Nuk më duhet askush tjetër
U mësova me vetminë time
Nga xhepat e së cilës i nxjerri
Të gjitha kujtimet e së kaluarës

41

PO MUNGOVE TI

Pa ty
Dhe frymëmarrjen tënde
Asgjë nuk më duhet
Në këto çaste

Për çfarë më duhet pasqyra
Kë të shikoj
Dhe me kë të bisedoj
Përtej amalgamës

Pa ty
Po më kafshon kjo zbrazëti
Pa ty dhe duart e tua
Bota më duket si skëterrë

Të thashë dhe sërish
Po të them
Asgjë nuk më duhet në këto çaste
Po mungove ti

ADEM ZAPLLUZHA

PO MUNGOVE TI

Pa ty
Dhe frymëmarrjen tënde
Asgjë nuk më duhet
Në këto çaste

Për çfarë më duhet pasqyra
Kë të shikoj
Dhe me kë të bisedoj
Përtej amalgamës

Pa ty
Po më kafshon kjo zbrazëti
Pa ty dhe duart e tua
Bota më duket si skëterrë

Të thashë dhe sërish
Po të them
Asgjë nuk më duhet në këto çaste
Po mungove ti

42

SHTEGTARI I FUSHAVE DHE I MALEVE

Për çfarë nuk thura vargje
Deri më sot
Për njerëzit me teke
Dhe dykrenorët
Por asnjëherë nuk thura asnjë varg
Për shtërgun që fle mbi çatinë time

S'desha të shkruaj
Sepse për çdo vjeshtë
Dimëron jashtë kujtesës së hapësirës
Më harron
Thua se kurrë nuk kam ekzistuar
Në sqepin e tij të brishtë

Aq shumë e desha
Sa që njëherë me një rast
Provova të fluturoj me të
Por më tradhtoi mendja
Dhe forca ime mistike
Sa që mbeta vetëm një copë dëshire

KUR DËNESIN VARRET

SHTEGTARI I FUSHAVE DHE I MALEVE

Për çfarë nuk thura vargje
Deri më sot
Për njerëzit me teke
Dhe dykrenorët
Por asnjëherë nuk thura asnjë varg
Për shtërgun që fle mbi çatinë time

S'desha të shkruaj
Sepse për çdo vjeshtë
Dimëron jashtë kujtesës së hapësirës
Më harron
Thua se kurrë nuk kam ekzistuar
Në sqepin e tij të brishtë

Aq shumë e desha
Sa që njëherë me një rast
Provova të fluturoj me të
Por më tradhtoi mendja
Dhe forca ime mistike
Sa që mbeta vetëm një copë dëshire

43

Mbeta me pritë kthimin
E tij në çerdhen e vjetër
Por kurrë më nuk u kthye miku im
Shtegtari i fushave dhe i maleve
Nuk u kthye
Të ma sjelli amanetin e shumëpritur

ADEM ZAPLLUZHA

Mbeta me pritë kthimin
E tij në çerdhen e vjetër
Por kurrë më nuk u kthye miku im
Shtegtari i fushave dhe i maleve
Nuk u kthye
Të ma sjelli amanetin e shumëpritur

SA HERË QË MË SHIKON

Të thashë se jam një hije
Pasqyra e një kohe
E cila iku
Dhe kurrë më nuk u kthye
Me i marr sandalet e kuqe të hënës

Ishin kohërat alegorike
Për një thumb të ndryshkur patkoi
Vdiste kali im
Vdiste edhe kali i luftës
Në betejën e përgjakur të njerëzimit

Sërish po të them se jam një hije
Pasqyra e varur në murin e kujtesës
Sa herë që më shikon
Do të të kujtohet fëmijëria
Dhe këpucët e grisura të Lulit

KUR DËNESIN VARRET

SA HERË QË MË SHIKON

Të thashë se jam një hije
Pasqyra e një kohe
E cila iku
Dhe kurrë më nuk u kthye
Me i marr sandalet e kuqe të hënës

Ishin kohërat alegorike
Për një thumb të ndryshkur patkoi
Vdiste kali im
Vdiste edhe kali i luftës
Në betejën e përgjakur të njerëzimit

Sërish po të them se jam një hije
Pasqyra e varur në murin e kujtesës
Sa herë që më shikon
Do të të kujtohet fëmijëria
Dhe këpucët e grisura të Lulit

45

DELET E QIELLIT

Një vijë e lakuar në horizont
Dhe unaza e mbrëmjes
Në mes të unazës
Galopojnë si kuajt e egër
Dy meteorë me bisht

Dikur vonë
Mbas një vrapi të çmendur
Yjet ndryshojnë itinerarin
Dalin jashtë binarëve
Dhe pikojnë në flokët e thinjura të tokës

Jashtë në oborr shoh vrizmën
E parë të shiut imcak
Delet e qiellit
Paskan ikur nga kullosat
Një hënë e re ndriçon hapësirën e mbytur

ADEM ZAPLLUZHA

DELET E QIELLIT

Një vijë e lakuar në horizont
Dhe unaza e mbrëmjes
Në mes të unazës
Galopojnë si kuajt e egër
Dy meteorë me bisht

Dikur vonë
Mbas një vrapi të çmendur
Yjet ndryshojnë itinerarin
Dalin jashtë binarëve
Dhe pikojnë në flokët e thinjura të tokës

Jashtë në oborr shoh vrizmën
E parë të shiut imcak
Delet e qiellit
Paskan ikur nga kullosat
Një hënë e re ndriçon hapësirën e mbytur

46

E KEQJA PO RRITET SI URAGAN

Mos rri mbyllur në vetvete
Dil nga ajo dhembje
E cila të mban gjallë
Në mallkimin e Olimpit
Ka kohë që kanë vdekur perëndit

Asnjë zot tjetër në qytetin tim
Nuk u lind nga dashuria
Por të gjitha zotat
U lindën nga frika
Ik nga ajo mbretëri e tmerrit

Ik të thashë mos më lodh më
Më kanë lodhur edhe tregimet e tua
Fantazmagorike
Më kanë dërmuar me fund
Njëherë e përgjithmonë dyshimet e tua

Koha është t'i varrosim të ligat
E keqja po rritet si uragan
Dil nga ai arkivol i trishtimit
Shiko se si nëpër zgërbonjat e varreve
Luajnë një valle djajtë e zinj

KUR DËNESIN VARRET

E KEQJA PO RRITET SI URAGAN

Mos rri mbyllur në vetvete
Dil nga ajo dhembje
E cila të mban gjallë
Në mallkimin e Olimpit
Ka kohë që kanë vdekur perëndit

Asnjë zot tjetër në qytetin tim
Nuk u lind nga dashuria
Por të gjitha zotat
U lindën nga frika
Ik nga ajo mbretëri e tmerrit

Ik të thashë mos më lodh më
Më kanë lodhur edhe tregimet e tua
Fantazmagorike
Më kanë dërmuar me fund
Njëherë e përgjithmonë dyshimet e tua

Koha është t'i varrosim të ligat
E keqja po rritet si uragan
Dil nga ai arkivol i trishtimit
Shiko se si nëpër zgërbonjat e varreve
Luajnë një valle djajtë e zinj

47

U SHTERËN SI ZËRAT E KËNGËVE

Më kujtohet si sot
Kur në kohën e adoleshencës
I dëgjonim kambanat e yjeve
I dëgjonim
Edhe psalmet e meteorëve

Qielli na dukej si një qilim
I thurur me miliona yjesh
Që vezullonin
Nën hijet e baladave
Hapësirën e galaktikës

Mbrëmë ishte pakëz më ndryshe
I dëgjuam këngët
I përjetuam vallet e shtojzovalleve
Qielli na dukej si një harmoni
E qëndisur prej yjeve

Më vonë erdhën nga majat
Rrebeshet e shirave
U shterën krojet tok me vallet e lashta
U shterën si zërat e këngëve
Që këndonin sirenat për kthimin e Uliksit

ADEM ZAPLLUZHA

U SHTERËN SI ZËRAT E KËNGËVE

Më kujtohet si sot
Kur në kohën e adoleshencës
I dëgjonim kambanat e yjeve
I dëgjonim
Edhe psalmet e meteorëve

Qielli na dukej si një qilim
I thurur me miliona yjesh
Që vezullonin
Nën hijet e baladave
Hapësirën e galaktikës

Mbrëmë ishte pakëz më ndryshe
I dëgjuam këngët
I përjetuam vallet e shtojzovalleve
Qielli na dukej si një harmoni
E qëndisur prej yjeve

Më vonë erdhën nga majat
Rrebeshet e shirave
U shterën krojet tok me vallet e lashta
U shterën si zërat e këngëve
Që këndonin sirenat për kthimin e Uliksit

48

KUR MI VUNË PRANGAT FJALËVE

Gjithmonë i kisha dyert e mbyllura
Trokita
Njëmijë vjet trokita
Në shpirtin e atdheut të vibruar
Por kurrë nuk mi hapën dyert

Isha vrima e fundit
Te një kavall prej druri
Ku asnjëherë nuk i luajta gishtat
Në vend meje
Luanin të tjerët sipas qejfit të tyre

Isha dhe jam ende
Një rebel i papërmirësueshëm
Për një fije kashte si Neroni
Mund t'i ndezja të gjitha qytetet
Isha një person që i shëmbëlleja rrapit

Kur mi vunë prangat e fjalëve
Unë këndova
Isha rapsodi i cili mund të këndonte
Me vitet të tëra
Pa përsëritur asnjëherë të njëjtën këngë

KUR DËNESIN VARRET

KUR MI VUNË PRANGAT FJALËVE

Gjithmonë i kisha dyert e mbyllura
Trokita
Njëmijë vjet trokita
Në shpirtin e atdheut të vibruar
Por kurrë nuk mi hapën dyert

Isha vrima e fundit
Te një kavall prej druri
Ku asnjëherë nuk i luajta gishtat
Në vend meje
Luanin të tjerët sipas qejfit të tyre

Isha dhe jam ende
Një rebel i papërmirësueshëm
Për një fije kashte si Neroni
Mund t'i ndezja të gjitha qytetet
Isha një person që i shëmbëlleja rrapit

Kur mi vunë prangat e fjalëve
Unë këndova
Isha rapsodi i cili mund të këndonte
Me vitet të tëra
Pa përsëritur asnjëherë të njëjtën këngë

49

NJË KALË I ËNDRRAVE

Ky kalë as i zi
E as i bardhë
Me një hingëllim të tejdukshëm
Asnjëherë nuk e ndali
Trokun e egër të vrapit

Mbi të kalëruan njerëz
Dhe perëndi
Ky kalë
As i bardhë e as i zi
Sa kishte hijeshi vrapi i tij

Si fëmijë pata shumë dëshirë
Të kalëroj
Një kalë as të bardhë
E as të zi
Të kalëroj edhe unë si perëndi

Të kalëroj furishëm
Mbi një kalë
As i bardhë e as i zi
Një kalë i ëndrrave
Më ndiqte që në fëmijëri

ADEM ZAPLLUZHA

NJË KALË I ËNDRRAVE

Ky kalë as i zi
E as i bardhë
Me një hingëllim të tejdukshëm
Asnjëherë nuk e ndali
Trokun e egër të vrapit

Mbi të kalëruan njerëz
Dhe perëndi
Ky kalë
As i bardhë e as i zi
Sa kishte hijeshi vrapi i tij

Si fëmijë pata shumë dëshirë
Të kalëroj
Një kalë as të bardhë
E as të zi
Të kalëroj edhe unë si perëndi

Të kalëroj furishëm
Mbi një kalë
As i bardhë e as i zi
Një kalë i ëndrrave
Më ndiqte që në fëmijëri

50

KUR MË MUROSËN ME HESHTJEN

Më vranë në një stinë
Pa stinë
Iku edhe kali im
Iku përtej ëndrrës sime
Si një shigjetë e ngjyer në helm

Nuk di a thua vallë
Isha duke ardhur
Ose ua kisha mbathur këmbëve
Dhe ikja ime
Nuk kishte të ndalur askund

Dy fjalë goje më mbetën peng
Nuk thashë asgjë
Për etjen e rrënjëve
Dy lloj lulesh rriteshin në kopsht
Një lloj me aromë tjetri me helm

Dy fjalë goje ende sot
Më ndjekin me qindra makthe
Dhe kurrë nuk kuptova
Se çfarë desha të them atë ditë
Kur më murosën me heshtjen

KUR DËNESIN VARRET

KUR MË MUROSËN ME HESHTJEN

Më vranë në një stinë
Pa stinë
Iku edhe kali im
Iku përtej ëndrrës sime
Si një shigjetë e ngjyer në helm

Nuk di a thua vallë
Isha duke ardhur
Ose ua kisha mbathur këmbëve
Dhe ikja ime
Nuk kishte të ndalur askund

Dy fjalë goje më mbetën peng
Nuk thashë asgjë
Për etjen e rrënjëve
Dy lloj lulesh rriteshin në kopsht
Një lloj me aromë tjetri me helm

Dy fjalë goje ende sot
Më ndjekin me qindra makthe
Dhe kurrë nuk kuptova
Se çfarë desha të them atë ditë
Kur më murosën me heshtjen

51

QANTE EDHE KALI IM I VERBËR

Ishte dita e shtatë
Kur qaja me ngashërim
Qaja sepse nuk desha
T'i frikoj zogjtë në fluturim

Për befasinë time
Qau edhe hëna në horizont
Yjet kishin mbetur peng
Diku mes meje dhe hapësirës së vdekur

Atë ditë pashë
Se si qanin edhe zogjtë
Qante edhe kali im i verbër
Qante se kuptoi për vdekjen e Trojës

Asnjë enigmë nuk mbeti në këmbë
Në dy gjunjë ranë baladat
Tok me legjendat e vjetra
U shembën përgjithmonë edhe perënditë

ADEM ZAPLLUZHA

QANTE EDHE KALI IM I VERBËR

Ishte dita e shtatë
Kur qaja me ngashërim
Qaja sepse nuk desha
T'i frikoj zogjtë në fluturim

Për befasinë time
Qau edhe hëna në horizont
Yjet kishin mbetur peng
Diku mes meje dhe hapësirës së vdekur

Atë ditë pashë
Se si qanin edhe zogjtë
Qante edhe kali im i verbër
Qante se kuptoi për vdekjen e Trojës

Asnjë enigmë nuk mbeti në këmbë
Në dy gjunjë ranë baladat
Tok me legjendat e vjetra
U shembën përgjithmonë edhe perënditë

52

ISHA POETI MË I SHTHURUR NË BOTË

Unë i kisha ëndrrat më të mira
Saherë që doja
Nën një pemë më priste
Një vashë si shtojzovallja

Më priste edhe në gjumë
Kur buzë lumit i përkundja
Mendimet e pasosura
Për vashat që më prisnin te pemët

Sa herë që desha putha
Nga një sirenë deti në ëndërr
Kur kthehesha në Itakë
Me të gjitha anijet e dynjasë

Isha poeti më i shthurur në botë
Putha sa herë që më donte shpirti
Me ëndrrat e ëndërruara
Nuk mund të krahasohej asnjë perëndi

KUR DËNESIN VARRET

ISHA POETI MË I SHTHURUR NË BOTË

Unë i kisha ëndrrat më të mira
Saherë që doja
Nën një pemë më priste
Një vashë si shtojzovallja

Më priste edhe në gjumë
Kur buzë lumit i përkundja
Mendimet e pasosura
Për vashat që më prisnin te pemët

Sa herë që desha putha
Nga një sirenë deti në ëndërr
Kur kthehesha në Itakë
Me të gjitha anijet e dynjasë

Isha poeti më i shthurur në botë
Putha sa herë që më donte shpirti
Me ëndrrat e ëndërruara
Nuk mund të krahasohej asnjë perëndi

53

SILLEJ BËRTHAMA E HESHTJES

Atë ditë isha fillikat i vetëm
Askush nuk më priste
Te shtegu posa i çelur
Para meje kishin kaluar
Me qindra dashnor të dështuar

Nuk më priste njeri
As nuk e prisja askënd
Vetëm fati im i çmendur
Sillej çmendurisht
Rrotull meje kali i egër i fëmijërisë

Sillej edhe një ëndërr
E pa ëndërruar dikur moti
Rreth e rrotull shtegut të zi
Sillej bërthama e heshtjes
Që më përvëlonte si pritja

ADEM ZAPLLUZHA

SILLEJ BËRTHAMA E HESHTJES

Atë ditë isha fillikat i vetëm
Askush nuk më priste
Te shtegu posa i çelur
Para meje kishin kaluar
Me qindra dashnor të dështuar

Nuk më priste njeri
As nuk e prisja askënd
Vetëm fati im i çmendur
Sillej çmendurisht
Rrotull meje kali i egër i fëmijërisë

Sillej edhe një ëndërr
E pa ëndërruar dikur moti
Rreth e rrotull shtegut të zi
Sillej bërthama e heshtjes
Që më përvëlonte si pritja

54

NUK BELBËZOVE ASNJË FJALË

Ishte një dimër i acartë
Unë nuk desha ta frikoj askënd
Por hejet si shigjeta prej zjarri
Nguleshin në trupin tim

Nuk durohen këto dhembje
S'durohet dot fjala e jote
Sa shumë kisha mall për një përqafim
Sa shumë doja atë ditë një puthje

Çfarë nuk doja ato çaste
Deliriumi
Hijet binin si hejet në tokë
Lëshoheshin pingul në gjakun tim

Desha të heshti por ja që
Nuk kisha forcë njeriu
Ulërita si bisha e malit
Sa që gjethet ranë në tokë

Ti heshte si guri i varrit
Nuk belbëzove asnjë fjalë
Vetëm dimri i acartë kaloi në heshtje
Nëpër shqisat e lodhura të mbrëmjes

KUR DËNESIN VARRET

NUK BELBËZOVE ASNJË FJALË

Ishte një dimër i acartë
Unë nuk desha ta frikoj askënd
Por hejet si shigjeta prej zjarri
Nguleshin në trupin tim

Nuk durohen këto dhembje
S'durohet dot fjala e jote
Sa shumë kisha mall për një përqafim
Sa shumë doja atë ditë një puthje

Çfarë nuk doja ato çaste
Deliriumi
Hijet binin si hejet në tokë
Lëshoheshin pingul në gjakun tim

Desha të heshti por ja që
Nuk kisha forcë njeriu
Ulërita si bisha e malit
Sa që gjethet ranë në tokë

Ti heshte si guri i varrit
Nuk belbëzove asnjë fjalë
Vetëm dimri i acartë kaloi në heshtje
Nëpër shqisat e lodhura të mbrëmjes

55

KJO ZËZËLLIMË E ÇMENDUR

Më duket se bankrotuan TV-të
E kësaj bote të shthurur
Asnjë lajmë i mirëfilltë
Nuk më paraqitet në ekran
Dikush një palë doreza
Ua gjuajti në fytyrë të gazetarëve

Mbase vdiqën zërat e teleferikëve
Heshtën edhe shtyllat e telefonave
S'lëshojnë asnjë zë
Vetëm ato telegrafike
Sjellin lajme bajate
Që nga shekulli i kaluar

Një heshtje e pa përshkruar
Lëshon disa xixa fjalësh memece
Askush askujt nuk i flet
Kjo zëzëllimë e çmendur
Mi mori mentë
Kujt t'i drejtohem në këto çaste

ADEM ZAPLLUZHA

KJO ZËZËLLIMË E ÇMENDUR

Më duket se bankrotuan TV-të
E kësaj bote të shthurur
Asnjë lajmë i mirëfilltë
Nuk më paraqitet në ekran
Dikush një palë doreza
Ua gjuajti në fytyrë të gazetarëve

Mbase vdiqën zërat e teleferikëve
Heshtën edhe shtyllat e telefonave
S'lëshojnë asnjë zë
Vetëm ato telegrafike
Sjellin lajme bajate
Që nga shekulli i kaluar

Një heshtje e pa përshkruar
Lëshon disa xixa fjalësh memece
Askush askujt nuk i flet
Kjo zëzëllimë e çmendur
Mi mori mentë
Kujt t'i drejtohem në këto çaste

56

RANË CA VRIZMA SHIU

Qielli lakuriq
I zhveshur deri në asht
Rrallë ndonjë re e plumbtë
Mbulon lëkurën e grisur të hapësirës
Me vite të tëra nuk ra shi në qytetin tim

Nëpër fusha bredhin të hutuara
Delet e arratisura
Barinjtë dhe bareshat
Nëpër trastat e tyre
Kërkojnë vathin e humbur

Askund asnjë fërkemë mbi
Borën e kuqe
Dita e përgjakur nga thikat
Përjeton dhembjen e fundit
Nëpër librat e shenjt zhduket e nesërmja

Dikur vonë shumë vonë
Ranë ca vrizma shiu
Por aq shumë toka kishte etje
Sa që nuk iu lag as loti i syrit
Që dëneste si një foshnje e braktisur

KUR DËNESIN VARRET

RANË CA VRIZMA SHIU

Qielli lakuriq
I zhveshur deri në asht
Rrallë ndonjë re e plumbtë
Mbulon lëkurën e grisur të hapësirës
Me vite të tëra nuk ra shi në qytetin tim

Nëpër fusha bredhin të hutuara
Delet e arratisura
Barinjtë dhe bareshat
Nëpër trastat e tyre
Kërkojnë vathin e humbur

Askund asnjë fërkemë mbi
Borën e kuqe
Dita e përgjakur nga thikat
Përjeton dhembjen e fundit
Nëpër librat e shenjt zhduket e nesërmja

Dikur vonë shumë vonë
Ranë ca vrizma shiu
Por aq shumë toka kishte etje
Sa që nuk iu lag as loti i syrit
Që dëneste si një foshnje e braktisur

57

KUR TË KTHEHEM NË ATDHE

Kur të kthehem në vendlindje
Do shoh
Se sa shumë janë rritur
Zambakët e bardhë
Ky qytet i Lidhjes
Mban në kujtesën e tij
Nënat veshur me tesha të zeza

Kur të kthehem në Qytetin e Lidhjes
Domosdo që do jehojnë
Daullet e një kohe
Kur Evropa na e rropi lëkurën
Na griu si duhanin
Në havanin e trishtuar të kohës
I kafshoi kufijtë e atdheut

Kur të kthehem nëse kthehem
Në Qytetin e Lidhjes
Do mbjelli një rrap të madh
Që i lëshon rrënjët
Përtej kufijve të atdheut
Që i lëshon rrënjët
Deri te sinorët e etërve

ADEM ZAPLLUZHA

KUR TË KTHEHEM NË ATDHE

Kur të kthehem në vendlindje
Do shoh
Se sa shumë janë rritur
Zambakët e bardhë
Ky qytet i Lidhjes
Mban në kujtesën e tij
Nënat veshur me tesha të zeza

Kur të kthehem në Qytetin e Lidhjes
Domosdo që do jehojnë
Daullet e një kohe
Kur Evropa na e rropi lëkurën
Na griu si duhanin
Në havanin e trishtuar të kohës
I kafshoi kufijtë e atdheut

Kur të kthehem nëse kthehem
Në Qytetin e Lidhjes
Do mbjelli një rrap të madh
Që i lëshon rrënjët
Përtej kufijve të atdheut
Që i lëshon rrënjët
Deri te sinorët e etërve

58

ME BASTUNIN TIM TË TROKAS

Më duket se janë përzier qeleshet
Në këtë stinë
Unë nuk i ndjej duar e mia
Janë si dy purtekë
Në fillim
Ose në fund të stinëve

Dimrat janë të gjatë
Kurse behari
E ka humbur rrugën
Dhe nuk di të kthehet në shtëpi
Në pragjet e drunjta të faltoreve
I ka harruar dorezat

Unë pres që të ndryshojnë stinët
Dimri të bëhet behar
Kurse behari dimër
Me bastunin tim të trokas
Nëpër ato porta
Që nuk mbylleshin asnjëherë për miqtë

KUR DËNESIN VARRET

ME BASTUNIN TIM TË TROKAS

Më duket se janë përzier qeleshet
Në këtë stinë
Unë nuk i ndjej duar e mia
Janë si dy purtekë
Në fillim
Ose në fund të stinëve

Dimrat janë të gjatë
Kurse behari
E ka humbur rrugën
Dhe nuk di të kthehet në shtëpi
Në pragjet e drunjta të faltoreve
I ka harruar dorezat

Unë pres që të ndryshojnë stinët
Dimri të bëhet behar
Kurse behari dimër
Me bastunin tim të trokas
Nëpër ato porta
Që nuk mbylleshin asnjëherë për miqtë

59

I DUA PA MASË STINËT E LULEVE

Nuk kam më kohë
Do shkoj atje ku vdesin dimrat
Kjo stinë e mjegullave
Tmerrësisht po ma zë frymën

Më duhet të shkoj atje
Ku nuk numërohen ditët e stinëve
Nga xhepat e grisura të mjegullave
Do bëjë një tjetër stinë

Ju thashë se nuk kam më kohë
Që ta pres
Që ta ma rregulloi itinerarin
Unë do nisem fillikat vetëm te varret

Kur të mbërri deri atje ku duhet
Ku nuk lindin
E as ku nuk vdesin dimrat
Do ju dërgoj një kartolinë të kaltër

Besoj se nuk do më kundërshtoni
Unë i dua udhëtimet dhe dimrat
Ku acari nuk e ngrinë gjakun
I dua pa masë stinët e luleve

ADEM ZAPLLUZHA

I DUA PA MASË STINËT E LULEVE

Nuk kam më kohë
Do shkoj atje ku vdesin dimrat
Kjo stinë e mjegullave
Tmerrësisht po ma zë frymën

Më duhet të shkoj atje
Ku nuk numërohen ditët e stinëve
Nga xhepat e grisura të mjegullave
Do bëjë një tjetër stinë

Ju thashë se nuk kam më kohë
Që ta pres
Që ta ma rregulloi itinerarin
Unë do nisem fillikat vetëm te varret

Kur të mbërri deri atje ku duhet
Ku nuk lindin
E as ku nuk vdesin dimrat
Do ju dërgoj një kartolinë të kaltër

Besoj se nuk do më kundërshtoni
Unë i dua udhëtimet dhe dimrat
Ku acari nuk e ngrinë gjakun
I dua pa masë stinët e luleve

60

MBETËN UDHËVE ME KASHTËN E KUMTRIT

Zogjtë u bënë gjethe
Dhe fluturuan përtej galaktikave
Një qiell i zymtë
Natë e ditë po dënes
Sa që hëna mbeti pa asnjë pikë loti

Vajtuan edhe yjet
Por gjethet e harruan rrugën
Nuk u kthyen kurrë më
Ndoshta mbetën te përralla
Ose baladat i mbyllën të gjitha portat

mbase ngjau e kundërta
Retë u bënë gjethe
Dhe fluturuan nëpër zymtësinë e qiejve
Kurrë më nuk u kthyen në atdhe
Mbetën udhëve me kashtën e kumtrit

KUR DËNESIN VARRET

MBETËN UDHËVE ME KASHTËN E KUMTRIT

Zogjtë u bënë gjethe
Dhe fluturuan përtej galaktikave
Një qiell i zymtë
Natë e ditë po dënes
Sa që hëna mbeti pa asnjë pikë loti

Vajtuan edhe yjet
Por gjethet e harruan rrugën
Nuk u kthyen kurrë më
Ndoshta mbetën te përralla
Ose baladat i mbyllën të gjitha portat

mbase ngjau e kundërta
Retë u bënë gjethe
Dhe fluturuan nëpër zymtësinë e qiejve
Kurrë më nuk u kthyen në atdhe
Mbetën udhëve me kashtën e kumtrit

61

DESH VDIQËN NGA ETJA

Kurrë nuk kam qenë
Aq shumë i trishtuar
Se sa atë ditë kur pashë
Se si qanin ullinjtë
Qanin si foshnjat e braktisura
Te pragjet e gurta të altarëve

Qanin edhe rrënjët
Një gjinkallë u ulë mbi degët e thyera
Dhe kurrë më nuk e ndali
Vajin e saj të trishtuar
Qau aq shumë
Sa që u molisën gjethet

Binte një tjetër lloj shiu atë ditë
Një shi si me litar i lidhi rrënjët
Ua zuri frymën
Desh vdiqën nga etja
Gjethet që kishin mbetur
Nëpër degët e thyera

ADEM ZAPLLUZHA

DESH VDIQËN NGA ETJA

Kurrë nuk kam qenë
Aq shumë i trishtuar
Se sa atë ditë kur pashë
Se si qanin ullinjtë
Qanin si foshnjat e braktisura
Te pragjet e gurta të altarëve

Qanin edhe rrënjët
Një gjinkallë u ulë mbi degët e thyera
Dhe kurrë më nuk e ndali
Vajin e saj të trishtuar
Qau aq shumë
Sa që u molisën gjethet

Binte një tjetër lloj shiu atë ditë
Një shi si me litar i lidhi rrënjët
Ua zuri frymën
Desh vdiqën nga etja
Gjethet që kishin mbetur
Nëpër degët e thyera

62

DHE MBETI GJITHMONË DIMËR

Mos jeni të shurdhër
Unë trokas qe dyqind vjet
Askush nuk i hap dyert e metalta
Sërish dhe sërish trokas
Në portat e mbyllura nga brenda

Ku jeni ju o njerëz
Pas cilës vjeshtë ikët nga vetvetja
Këtu dimrave nuk bie shi
Vetëm bardhësia e dëborës
Si mbreti në fron ulet mbi këto fusha

Prapë po ju pyes
Mos jeni shurdhmemec
Cila vjeshtë iku nga qyteti i Lidhjes
Dhe mbeti gjithmonë dimër
Këtu në qytetin tim mbretëror

Dimër pas dimri s’pushuan të reshurat
Acaret ishin tërë trishtim
Sa që hejet
Si shigjeta të helmatisura
Thyheshin në gjakun tim

KUR DËNESIN VARRET

DHE MBETI GJITHMONË DIMËR

Mos jeni të shurdhër
Unë trokas qe dyqind vjet
Askush nuk i hap dyert e metalta
Sërish dhe sërish trokas
Në portat e mbyllura nga brenda

Ku jeni ju o njerëz
Pas cilës vjeshtë ikët nga vetvetja
Këtu dimrave nuk bie shi
Vetëm bardhësia e dëborës
Si mbreti në fron ulet mbi këto fusha

Prapë po ju pyes
Mos jeni shurdhmemec
Cila vjeshtë iku nga qyteti i Lidhjes
Dhe mbeti gjithmonë dimër
Këtu në qytetin tim mbretëror

Dimër pas dimri s’pushuan të reshurat
Acaret ishin tërë trishtim
Sa që hejet
Si shigjeta të helmatisura
Thyheshin në gjakun tim

63

FATI

Po të mos ishte fati
Nuk di
Si do të quheshin zotat
Asnjë perëndi
S'do ishte ulur në fronin e Olimpit

Por ja që deshi fati
Ose fatkeqësia
Që njëri prej tjetrit
Të dallohen njerëzit
I pari të kurorëzohet mbret
Kurse tjetri e poet

Fati ka nocion i rrallëkujt
Troket njëherë
Në njëmijë vjet
Troket te portat e mbyllura
Të gjysmë perëndive

Dikush lind me fat
Kurse dikush tjetër
Dymijë vjet
Kërkon fatin
I cili asnjëherë
Nuk trokiti në portat e mbyllura

ADEM ZAPLLUZHA

FATI

Po të mos ishte fati
Nuk di
Si do të quheshin zotat
Asnjë perëndi
S'do ishte ulur në fronin e Olimpit

Por ja që deshi fati
Ose fatkeqësia
Që njëri prej tjetrit
Të dallohen njerëzit
I pari të kurorëzohet mbret
Kurse tjetri e poet

Fati ka nocion i rrallëkujt
Troket njëherë
Në njëmijë vjet
Troket te portat e mbyllura
Të gjysmë perëndive

Dikush lind me fat
Kurse dikush tjetër
Dymijë vjet
Kërkon fatin
I cili asnjëherë
Nuk trokiti në portat e mbyllura

64

KURRË NUK NA LËNË REHAT

Kam ikur nga stërkalat e shiut
E vetmja gjë
Që më pengon janë pikat
Që pandërprere trokasin pa u ndalur
Mbi flokët e mia të thinjura

Këtu brenda dhomës
Shiu s'pushon
S'pushon as në korridorin e errët
Po bie me rrëmbim
Mbi flokët e verdha të vjeshtës

Kam të ftohtë ethet e verdha
Mbi njëqind vjet më sulmuan
Asnjëherë nuk munda të mësoj
Si t'i kundërvihem pikave monotone
Të shiut idhnak

Këtu saherë që ishte vjeshta
Ne mësuam se si dimrat u bënë më të egër
Na sulmuan nga të katër anët e sinorëve
Kurrë nuk na lënë rehat
T'i risim fëmijët sipas kutit tonë

KUR DËNESIN VARRET

KURRË NUK NA LËNË REHAT

Kam ikur nga stërkalat e shiut
E vetmja gjë
Që më pengon janë pikat
Që pandërprere trokasin pa u ndalur
Mbi flokët e mia të thinjura

Këtu brenda dhomës
Shiu s'pushon
S'pushon as në korridorin e errët
Po bie me rrëmbim
Mbi flokët e verdha të vjeshtës

Kam të ftohtë ethet e verdha
Mbi njëqind vjet më sulmuan
Asnjëherë nuk munda të mësoj
Si t'i kundërvihem pikave monotone
Të shiut idhnak

Këtu saherë që ishte vjeshta
Ne mësuam se si dimrat u bënë më të egër
Na sulmuan nga të katër anët e sinorëve
Kurrë nuk na lënë rehat
T'i risim fëmijët sipas kutit tonë

65

NGA TYTAT DHE SHPIRTRAT E DJEMURISË

Ishte koha kur çdo ditë
Rriteshin plagët
Së pari iku nëna me një arkivol të vogël
Më pastaj fatkeqësisht
Im atë iu bashkua etërve

Vdekje pas vdekjeje më përcollën në jetë
Na e vranë dykrenorin
Ai shpend gjigant
Asnjëherë nuk iu nënshtrua të huajve
Deshën të ma vrasin edhe atdheun

Nuk di a ishte fundi ose fillimi
Por një shpresë dukej në fund të tunelit
I shpalosëm qullet e kuajve
Nga çatitë e tavaneve
I zbritën dhe filluam t'i lyejmë pushkët

Atdheu filloi të marrë frymë
Nëpër male u ndezën flakadanët e lirisë
Nga tytat dhe shpirtrat e djemurisë
Jehuan këngët
Malet ngritën dollinë për çlirimin e atdheut

Prishtinë, 14 nëntor 2018

ADEM ZAPLLUZHA

NGA TYTAT DHE SHPIRTRAT E DJEMURISË

Ishte koha kur çdo ditë
Rriteshin plagët
Së pari iku nëna me një arkivol të vogël
Më pastaj fatkeqësisht
Im atë iu bashkua etërve

Vdekje pas vdekjeje më përcollën në jetë
Na e vranë dykrenorin
Ai shpend gjigant
Asnjëherë nuk iu nënshtrua të huajve
Deshën të ma vrasin edhe atdheun

Nuk di a ishte fundi ose fillimi
Por një shpresë dukej në fund të tunelit
I shpalosëm qullet e kuajve
Nga çatitë e tavaneve
I zbritën dhe filluam t'i lyejmë pushkët

Atdheu filloi të marrë frymë
Nëpër male u ndezën flakadanët e lirisë
Nga tytat dhe shpirtrat e djemurisë
Jehuan këngët
Malet ngritën dollinë për çlirimin e atdheut

Prishtinë, 14 nëntor 2018

66

Cikli i tretë
Me një kartolinë në sqep

KUR DËNESIN VARRET

Cikli i tretë
Me një kartolinë në sqep

67

ADEM ZAPLLUZHA

68

ISHTE TEPËR VONË

Nuk i dalloja dot nuancat
Ishte një mëngjes i errët
Ose mbrëmja kishte ardhur para kohe
Por gjithsesi
Ishte një kohë asnjanëse

Nga duart e lodhura të pemëve
Pikonte një lloj rrëshire
Por nuk ishte as rrëshirë e as vesë
Diçka pa shije dhe formë
Zbrite nga degët e lodhura

Unë prita një kohë të gjatë
Prita t'i definojë ngjyrat e nuancave
Por ishte e pamundur
Të depërtoj në botën e ngjyrave
Mbete diku si hije në horizont

Kur kuptova se hëna kishte
Përjetuar një lloj gjysmë eklipsi
Ishte tepër vonë
Të kthehem në atdhe
Sepse çdo betejë kishte përfunduar

KUR DËNESIN VARRET

ISHTE TEPËR VONË

Nuk i dalloja dot nuancat
Ishte një mëngjes i errët
Ose mbrëmja kishte ardhur para kohe
Por gjithsesi
Ishte një kohë asnjanëse

Nga duart e lodhura të pemëve
Pikonte një lloj rrëshire
Por nuk ishte as rrëshirë e as vesë
Diçka pa shije dhe formë
Zbrite nga degët e lodhura

Unë prita një kohë të gjatë
Prita t'i definojë ngjyrat e nuancave
Por ishte e pamundur
Të depërtoj në botën e ngjyrave
Mbete diku si hije në horizont

Kur kuptova se hëna kishte
Përjetuar një lloj gjysmë eklipsi
Ishte tepër vonë
Të kthehem në atdhe
Sepse çdo betejë kishte përfunduar

69

PIKONTE NË SHPIRTIN E TYRE

Mes gazetave të vjetra
Ishte shtrirë spitali
Të sëmurët psikik kishin harruar
Se si lexohen shkronjat e plumbta
Kishin harruar
Edhe emrat e njëri-tjetrit

Mbi baltën e mbuluar me shiringa
Nuk dallohej plaga e shpirtit
Ka kohë që kishte ikur dita
Nën hijet e shkundura të pemëve
Kjo mbrëmje monotone qëndronte
Si statujat e mermerta

Dikur vonë tepër vonë
Dikujt i ra ndërmend se duhen të flenë
U shtrinë nën hijet e lisave të trashë
Dhe shikonin se si pikonte errësira
Pikonte në shpirtin e tyre
Një lloj katrani i pa definuar

ADEM ZAPLLUZHA

PIKONTE NË SHPIRTIN E TYRE

Mes gazetave të vjetra
Ishte shtrirë spitali
Të sëmurët psikik kishin harruar
Se si lexohen shkronjat e plumbta
Kishin harruar
Edhe emrat e njëri-tjetrit

Mbi baltën e mbuluar me shiringa
Nuk dallohej plaga e shpirtit
Ka kohë që kishte ikur dita
Nën hijet e shkundura të pemëve
Kjo mbrëmje monotone qëndronte
Si statujat e mermerta

Dikur vonë tepër vonë
Dikujt i ra ndërmend se duhen të flenë
U shtrinë nën hijet e lisave të trashë
Dhe shikonin se si pikonte errësira
Pikonte në shpirtin e tyre
Një lloj katrani i pa definuar

70

NË PELLGUN E NJË COPE MJEGULLE

Kisha harruar se ku ndodhem
Një këndes prej teneqeje
Dhe çatia e rrënuar
Kishin mbetur gjysmë të varur
Nëpër degët e gështenjave

Nga kjo perspektivë
Nuk mund të shikoja hapësirën
Se si mbytej
Në pellgun e një copë mjegulle
Mbytej sepse kishte mbetur pa frymë

Atë natë të vonshëm
Binte nga pak shi nëpër çatitë e lagjes
Nga kjo monotoni
Nuk dëgjohej asnjë mjaullimë maceje
Kishin pushuar edhe të lehurat e qenve

Më duket se qyteti vdiste
Pa e lënë testamentin peng
Ndonjë kronisti të moshuar
Ishte koha kur qyteti kishte mbetur
Në dorë të askujt dhe historianëve anonim

KUR DËNESIN VARRET

NË PELLGUN E NJË COPE MJEGULLE

Kisha harruar se ku ndodhem
Një këndes prej teneqeje
Dhe çatia e rrënuar
Kishin mbetur gjysmë të varur
Nëpër degët e gështenjave

Nga kjo perspektivë
Nuk mund të shikoja hapësirën
Se si mbytej
Në pellgun e një copë mjegulle
Mbytej sepse kishte mbetur pa frymë

Atë natë të vonshëm
Binte nga pak shi nëpër çatitë e lagjes
Nga kjo monotoni
Nuk dëgjohej asnjë mjaullimë maceje
Kishin pushuar edhe të lehurat e qenve

Më duket se qyteti vdiste
Pa e lënë testamentin peng
Ndonjë kronisti të moshuar
Ishte koha kur qyteti kishte mbetur
Në dorë të askujt dhe historianëve anonim

71

GJITHKUSH PËR GJITHKEND I HUAJ NË KËTË QYTET

Dhomën e kafshonte lagështia
Kafshonte si mola
Pantallonat e grisura të vëllait të vogël
Çdo gjë paska ndryshua
Në qytetin tim të fëmijërisë

Shikoj fytyra të mavijosura
Me një pamje të mërrolur dhe alegorike
Më shikojnë portat e mbyllura
Që dikur ua prishja gjumin
Duke i gjuajtur me gur

Më duket se ende mbi gardhin e shtëpisë
Dikush i paska harruar
Pantallonat me xhepa të grisur
Prej gurëve
Që i mbaja për çdo rast

Të gjithë më paskan harruar
As unë nuk i njoh fytyrat
E politikanëve të rinj në këto afishe
Ngjitur nëpër muret e rrënuar
Gjithkush për gjithkënd i huaj në këtë qytet

ADEM ZAPLLUZHA

GJITHKUSH PËR GJITHKEND I HUAJ NË KËTË QYTET

Dhomën e kafshonte lagështia
Kafshonte si mola
Pantallonat e grisura të vëllait të vogël
Çdo gjë paska ndryshua
Në qytetin tim të fëmijërisë

Shikoj fytyra të mavijosura
Me një pamje të mërrolur dhe alegorike
Më shikojnë portat e mbyllura
Që dikur ua prishja gjumin
Duke i gjuajtur me gur

Më duket se ende mbi gardhin e shtëpisë
Dikush i paska harruar
Pantallonat me xhepa të grisur
Prej gurëve
Që i mbaja për çdo rast

Të gjithë më paskan harruar
As unë nuk i njoh fytyrat
E politikanëve të rinj në këto afishe
Ngjitur nëpër muret e rrënuar
Gjithkush për gjithkënd i huaj në këtë qytet

72

KU ENDE MË KUJTOHEN PLAKAT

Nëpër rrugicat e qytetit
Shoh njerëz duke kaluar
Shoh me fytyra të dërmuara
Nga lodhja e përditshmërisë
Me duart përplot rrudha
Nëpër xhepa shtrëngojnë kafshatën e bukës

Disa plaka nguten ta mbërrin
Meshën e së dielës
Fëmijët pa brenga i gjuajnë zogjtë
Nëpër kallamishte
Kurse kambana e lodhur me vështirësi
Ndahet nga tingujt e zërave të mesditës

Kështu edhe mund ta përfundoj
Këtë kronikë të përditshmërisë
Në qytetin tim të fëmijërisë
Ku ende më kujtohen plakat
Dhe zëri i meshtarit
Një bariton i thellë që kumbonte për bukuri

KUR DËNESIN VARRET

KU ENDE MË KUJTOHEN PLAKAT

Nëpër rrugicat e qytetit
Shoh njerëz duke kaluar
Shoh me fytyra të dërmuara
Nga lodhja e përditshmërisë
Me duart përplot rrudha
Nëpër xhepa shtrëngojnë kafshatën e bukës

Disa plaka nguten ta mbërrin
Meshën e së dielës
Fëmijët pa brenga i gjuajnë zogjtë
Nëpër kallamishte
Kurse kambana e lodhur me vështirësi
Ndahet nga tingujt e zërave të mesditës

Kështu edhe mund ta përfundoj
Këtë kronikë të përditshmërisë
Në qytetin tim të fëmijërisë
Ku ende më kujtohen plakat
Dhe zëri i meshtarit
Një bariton i thellë që kumbonte për bukuri

73

ME NJË KARTOLINË NË SQEP

Në një trastë të meshintë
I kishte fshehur kartolinat
Dhe historinë
E një dashurie në luftë

Ishte një dimër i acartë
Dëbora e kuqe
Dukej më e zjarrtë nga gjaku

Kartolinat dhe trasta e meshintë
Qëndronin varur
Në trupin e një rrapi kryeneç

Era i fuste hundët ngadalë
Në trastën e grisur
Ku mezi qëndronin letrat e palexuara

Ishte një histori e trishtuar e luftës
Letrat nuk i lexoi askush
Djaloshi me një dykrenor në kraharor

Ishte shtrirë në formë horizontale
Gjysmë mbrojtëse
Qëndronte ashtu
Siç e kishte marr plumbi

ADEM ZAPLLUZHA

ME NJË KARTOLINË NË SQEP

Në një trastë të meshintë
I kishte fshehur kartolinat
Dhe historinë
E një dashurie në luftë

Ishte një dimër i acartë
Dëbora e kuqe
Dukej më e zjarrtë nga gjaku

Kartolinat dhe trasta e meshintë
Qëndronin varur
Në trupin e një rrapi kryeneç

Era i fuste hundët ngadalë
Në trastën e grisur
Ku mezi qëndronin letrat e palexuara

Ishte një histori e trishtuar e luftës
Letrat nuk i lexoi askush
Djaloshi me një dykrenor në kraharor

Ishte shtrirë në formë horizontale
Gjysmë mbrojtëse
Qëndronte ashtu
Siç e kishte marr plumbi

74

Nga dhembja e madhe
Togu dukej
Si një statujë e mermertë

Askush nuk pati guxim
T'i lajmëroi prindërit
Për vdekjen heroike të vetmit djalë

Nga trasta e meshintë
Me një kartolinë në sqep
Doli një pëllumb i bardhë dhe fluturoi

KUR DËNESIN VARRET

Nga dhembja e madhe
Togu dukej
Si një statujë e mermertë

Askush nuk pati guxim
T'i lajmëroi prindërit
Për vdekjen heroike të vetmit djalë

Nga trasta e meshintë
Me një kartolinë në sqep
Doli një pëllumb i bardhë dhe fluturoi

PRESIN NË ANKTH

Mbi molin e mykur
Si gjithmonë
Tasa të vjetra konservash
Era loz tangon e saj të fundit

Dimri ende nuk ka mbërri
Dërrasat e lagura të anijeve
Me dy rrema
Kokulur shikojnë
Se si ngryset qielli i vjeshtës

Pakëz më tutje
Fëmijët i kanë lëshuar karremat
Për ta zënë peshkun e artë

Etërit e tyre
Ka ditë që nuk duken në mol
Thonë se është fundosur një varkë
Por vetëm ashtu thonë

Askush nuk beson pa i parë
Rremat që notojnë
Mbi valët e kripura të Jonit
Nënat i presin burrat
Presin në ankth
Kthimin e varkës së fundosur

ADEM ZAPLLUZHA

PRESIN NË ANKTH

Mbi molin e mykur
Si gjithmonë
Tasa të vjetra konservash
Era loz tangon e saj të fundit

Dimri ende nuk ka mbërri
Dërrasat e lagura të anijeve
Me dy rrema
Kokulur shikojnë
Se si ngryset qielli i vjeshtës

Pakëz më tutje
Fëmijët i kanë lëshuar karremat
Për ta zënë peshkun e artë

Etërit e tyre
Ka ditë që nuk duken në mol
Thonë se është fundosur një varkë
Por vetëm ashtu thonë

Askush nuk beson pa i parë
Rremat që notojnë
Mbi valët e kripura të Jonit
Nënat i presin burrat
Presin në ankth
Kthimin e varkës së fundosur

76

ULLINJTË DUKEN SI KARDINALË

Mbi çatitë përreth molit
Lëvizin me disa lëvizje elegante
Këndesat e metaltë

Pranë brigjeve të kripura
Mendueshëm duket Joni
A thua vallë çfarë mendojnë
Në këto çaste për anijet e fundosura

Dy pulëbardha të lodhura
Mezi qëndrojnë te kiçi
Një varkë e vjetër
Ëndërron kohërat e saja të ikura

Ullinjtë duken si kardinalë
Krenar dhe njëherë të lodhur
Nga vitet
Që u kaluan mbi shpatullat e dërmuara

Një mace e zgërlaqur i lëpinte
Konservat e hedhura

Më tutje afër tavernës
Dy marinarë të bërë tapë
Këndojnë një këngë të vjetër
Për detarët e dashuruar

KUR DËNESIN VARRET

ULLINJTË DUKEN SI KARDINALË

Mbi çatitë përreth molit
Lëvizin me disa lëvizje elegante
Këndesat e metaltë

Pranë brigjeve të kripura
Mendueshëm duket Joni
A thua vallë çfarë mendojnë
Në këto çaste për anijet e fundosura

Dy pulëbardha të lodhura
Mezi qëndrojnë te kiçi
Një varkë e vjetër
Ëndërron kohërat e saja të ikura

Ullinjtë duken si kardinalë
Krenar dhe njëherë të lodhur
Nga vitet
Që u kaluan mbi shpatullat e dërmuara

Një mace e zgërlaqur i lëpinte
Konservat e hedhura

Më tutje afër tavernës
Dy marinarë të bërë tapë
Këndojnë një këngë të vjetër
Për detarët e dashuruar

77

PËR TË SOTMEN E LODHUR

Gjërat që i bleva sot
Dhe disa të tjera në vjeshtën e kaluar
Më duket se u bënë harresë
Edhe shportën me vezë të kuqe
E paskam harruar
Te pragu i gurtë i kishës

Kështu gjithmonë ndodh me mua
Kam shumë dëshirë
Të blej
Dhe pastaj harroj se ku i lë gjërat
Ndoshta dikush tjetër
Do rastis që t'i gjej ato që i humba

Sa e sa vargje më kanë mbetur
Peng në Fushën e Mëllenjave
I shkruaja dhe i fshihja
Pas rrënjëve të thekrës
Vinte një gjinkallë
Dhe tërë stinën recitonte nëpër grunaja

Më duket se ishin vargje prej djerse
Sepse kur ndjeja lodhje
Pushoja duke shkruar
Për të sotmen e lodhur
Dhe për të nesërmen e dërmuar

ADEM ZAPLLUZHA

PËR TË SOTMEN E LODHUR

Gjërat që i bleva sot
Dhe disa të tjera në vjeshtën e kaluar
Më duket se u bënë harresë
Edhe shportën me vezë të kuqe
E paskam harruar
Te pragu i gurtë i kishës

Kështu gjithmonë ndodh me mua
Kam shumë dëshirë
Të blej
Dhe pastaj harroj se ku i lë gjërat
Ndoshta dikush tjetër
Do rastis që t'i gjej ato që i humba

Sa e sa vargje më kanë mbetur
Peng në Fushën e Mëllenjave
I shkruaja dhe i fshihja
Pas rrënjëve të thekrës
Vinte një gjinkallë
Dhe tërë stinën recitonte nëpër grunaja

Më duket se ishin vargje prej djerse
Sepse kur ndjeja lodhje
Pushoja duke shkruar
Për të sotmen e lodhur
Dhe për të nesërmen e dërmuar

78

OSE TË PIKTUROJ NJË DIELL

Ndonjëherë pa dashje
Me vjen ndërmend t'i emëroj gjerat
Me emrat e tyre
Ose të dikujt tjetër
Por gjithsesi t'i thërras
Ashtu si më pëlqejnë vetëm mua

Ka edhe çaste të tjera në jetë
Kur njeriu dëshiron
Të bie shi ose dëborë e kuqe
Të lëvizi në anën e kundërt
Të derdhjes së ujit
Dhe të mbërrijë deri te ëndrra e vetë

Po ju them se ka çaste
Kur njeriu dëshiron të bëhet zog
Ose të pikturoj një diell
Në murin e pasmë të shtëpisë
Ka çaste kur e zë për gryke vdekjen
Dhe përfundon në makth

KUR DËNESIN VARRET

OSE TË PIKTUROJ NJË DIELL

Ndonjëherë pa dashje
Me vjen ndërmend t'i emëroj gjerat
Me emrat e tyre
Ose të dikujt tjetër
Por gjithsesi t'i thërras
Ashtu si më pëlqejnë vetëm mua

Ka edhe çaste të tjera në jetë
Kur njeriu dëshiron
Të bie shi ose dëborë e kuqe
Të lëvizi në anën e kundërt
Të derdhjes së ujit
Dhe të mbërrijë deri te ëndrra e vetë

Po ju them se ka çaste
Kur njeriu dëshiron të bëhet zog
Ose të pikturoj një diell
Në murin e pasmë të shtëpisë
Ka çaste kur e zë për gryke vdekjen
Dhe përfundon në makth

79

PËRSE I PENGON DIKUJT

Nuk është me rëndësi
Se si ndihet era
Kur njeriu pështynë në tokë
Ka shumë e më shumë domethënie
Që njeriu nuk është vetvetja e vetë

Njëherë kur isha adoleshent
Më kujtohen disa raste qesharake
Kur u hipnim kuajve të egër
Për së mbrapshti
Dhe tërë kohën i kalëronim kalldrëmeve

Për ne ishte shumë interesant
Të jemi në qendër të vëmendjes
A e thyenim kokën
Apo jo
Kurrë nuk jemi merakosur

Ka çaste që njeriu dëshiron
Të jetë vetvetja e vet
Dhe kurrë nuk e kuptova
Përse i pengon dikujt
Që të jesh ai i cili kurrë nuk ish ti

ADEM ZAPLLUZHA

PËRSE I PENGON DIKUJT

Nuk është me rëndësi
Se si ndihet era
Kur njeriu pështynë në tokë
Ka shumë e më shumë domethënie
Që njeriu nuk është vetvetja e vetë

Njëherë kur isha adoleshent
Më kujtohen disa raste qesharake
Kur u hipnim kuajve të egër
Për së mbrapshti
Dhe tërë kohën i kalëronim kalldrëmeve

Për ne ishte shumë interesant
Të jemi në qendër të vëmendjes
A e thyenim kokën
Apo jo
Kurrë nuk jemi merakosur

Ka çaste që njeriu dëshiron
Të jetë vetvetja e vet
Dhe kurrë nuk e kuptova
Përse i pengon dikujt
Që të jesh ai i cili kurrë nuk ish ti

80

MË SHPËRFAQET NJË COPË MJEGULLE

Nuk isha asnjëherë i vetëm
Pas meje dëgjoheshin britmat
Nuk menin as vigmat e trishtuara
Prania ime
Pengonte djallëzitë e djajve të kuq

Sa herë që më kujtohet rinia
Nuk mund t'i harroj sytë
Dhe gishtin tregues
Të secilit njeri që bisedonte
Vetëm me atë gisht të prishtë

Kurrë nuk isha i vetëm
Një hije e zezë si një mallkim
I pashkruar
Më përcillte në secilin hap
Ishte hija e mjegullt e një rinie

Më duket se edhe sot
Më vijnë pas hijet e kuqe
Sa herë që e kthej kryet pas
Më shpërfaqet një copë mjegulle
Prej hijeve të dendura ngjashëm me gishtin

KUR DËNESIN VARRET

MË SHPËRFAQET NJË COPË MJEGULLE

Nuk isha asnjëherë i vetëm
Pas meje dëgjoheshin britmat
Nuk menin as vigmat e trishtuara
Prania ime
Pengonte djallëzitë e djajve të kuq

Sa herë që më kujtohet rinia
Nuk mund t'i harroj sytë
Dhe gishtin tregues
Të secilit njeri që bisedonte
Vetëm me atë gisht të prishtë

Kurrë nuk isha i vetëm
Një hije e zezë si një mallkim
I pashkruar
Më përcillte në secilin hap
Ishte hija e mjegullt e një rinie

Më duket se edhe sot
Më vijnë pas hijet e kuqe
Sa herë që e kthej kryet pas
Më shpërfaqet një copë mjegulle
Prej hijeve të dendura ngjashëm me gishtin

81

SI T'I PREKI FLOKËT E TUA KUR BËHEN ERË

Sa e sa herë desha të të preki
Çdo herë dhe në çdo kohë
Kam kuptuar
Se i kam gishtat e verbëta
Aq të verbëta
Sa që nuk shohin asgjë në dritë

Ndoshta gishtat e mi
I përkasin errësirës
Nga zëri i saj pikon drita
Pikon shikimi yt
Në shtatë lagje të varfanjakëve
Nuk mund të na takohen shikimet

Më kupto jam një qenie e lodhur
Më lodhi drita
Po ashtu edhe errësira
Si t'i preki me gishtat e mi
Trupin tënd të lëngtë
Si t'i preki flokët e tua kur bëhen erë

ADEM ZAPLLUZHA

SI T'I PREKI FLOKËT E TUA KUR BËHEN ERË

Sa e sa herë desha të të preki
Çdo herë dhe në çdo kohë
Kam kuptuar
Se i kam gishtat e verbëta
Aq të verbëta
Sa që nuk shohin asgjë në dritë

Ndoshta gishtat e mi
I përkasin errësirës
Nga zëri i saj pikon drita
Pikon shikimi yt
Në shtatë lagje të varfanjakëve
Nuk mund të na takohen shikimet

Më kupto jam një qenie e lodhur
Më lodhi drita
Po ashtu edhe errësira
Si t'i preki me gishtat e mi
Trupin tënd të lëngtë
Si t'i preki flokët e tua kur bëhen erë

82

NËPËR TRUPIN E BRISHTË TË HËNËS

Po më preke sonte
Nga gishtat e mi skelet
Do pikojnë lumenjtë e dynjasë
Ose ofshamat e të gjitha spitaleve
Të thashë po më preke
Do shkrihem si një copë akulli në diell

Gishtat e mi nuk më përkasin më
Vetëm mua
Janë një pjesë e pashpjegueshme
Në metabolizmin e fjalëve
Më kujtohet kur ishim bashkë
Preknim çfarë na donte qejfi

Ishin ato kohëra të bukura
Kur u lejoja
Të galopojnë si kuajt e paçjerrë
Nëpër trupin e brishtë të hënës
Kurse sot
Si mund ta kuptoni
Që nuk më përkasin vetëm mua

KUR DËNESIN VARRET

NËPËR TRUPIN E BRISHTË TË HËNËS

Po më preke sonte
Nga gishtat e mi skelet
Do pikojnë lumenjtë e dynjasë
Ose ofshamat e të gjitha spitaleve
Të thashë po më preke
Do shkrihem si një copë akulli në diell

Gishtat e mi nuk më përkasin më
Vetëm mua
Janë një pjesë e pashpjegueshme
Në metabolizmin e fjalëve
Më kujtohet kur ishim bashkë
Preknim çfarë na donte qejfi

Ishin ato kohëra të bukura
Kur u lejoja
Të galopojnë si kuajt e paçjerrë
Nëpër trupin e brishtë të hënës
Kurse sot
Si mund ta kuptoni
Që nuk më përkasin vetëm mua

83

PAS NJË ERRËSIRE TË PANJOHUR

Më duket se jam në fund të rrugës
Gjërat në jetë
Kanë fillimin dhe fundin
Unë mbase moti
Kam mbërri në fund
Dhe tani i numëroj pemët e shkulura

S'ka lidhje edhe nëse sonte
Dukem në fillim
Çdo fillim qëndron fort
Në këmbët e veta
Ashti siç qëndron edhe fundi
Pas një errësire të panjohur

Unë dhe hapi im i parë
Pa e anashkaluar
Frymëmarrjen e fundit
Jemi një ngjizje
Që aq shumë i ngjajmë njëri - tjetrit
Si lukunitë lukunive të egra të maleve

ADEM ZAPLLUZHA

PAS NJË ERRËSIRE TË PANJOHUR

Më duket se jam në fund të rrugës
Gjërat në jetë
Kanë fillimin dhe fundin
Unë mbase moti
Kam mbërri në fund
Dhe tani i numëroj pemët e shkulura

S'ka lidhje edhe nëse sonte
Dukem në fillim
Çdo fillim qëndron fort
Në këmbët e veta
Ashti siç qëndron edhe fundi
Pas një errësire të panjohur

Unë dhe hapi im i parë
Pa e anashkaluar
Frymëmarrjen e fundit
Jemi një ngjizje
Që aq shumë i ngjajmë njëri - tjetrit
Si lukunitë lukunive të egra të maleve

84

SËRISH DY ZOGJ TË KALTËR

Kur i prekëm zogjtë
Menduam se i lëmë të hapura dyert
Ishte nata e parë e një feste pagane
Nata kur njerëzit
Ngjiteshin në qiellin e shtatë

Unë nuk isha askund
Këmbët nuk e preknin as ajrin
E as tokën e shkriftë të atdheut
Dy zogj të kaltër
Veç kishin zbritur nga qielli

